

**LIGJ**  
**Nr.9235, datë 29.7.2004**  
**PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9684, datë 6.2.2007)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9898, datë 10.4.2008)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10 095, datë 12.3.2009)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10207, datë 23.12.2009)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr. Nr.10 186, datë 5.11.2009)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10308, datë 22.7.2010)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.49/2014, datë 8.5.2014)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.47/2015 datë 7.5.2015)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 41, 78, 83 pika 1 dhe 181 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj ka për objekt:

- a) rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet;
- b) kthimin dhe, aty ku sipas këtij ligji kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj;
- c) procedurat për realizimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe organet administrative të ngarkuara për realizimin e tyre.

**Neni 2**  
**E drejta e pronësisë**  
*(Shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës.

Fusha e veprimit të këtij ligji shtrihet edhe për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939 dhe që janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, datë 13.1.1945 “Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës”.

Neni 3  
**Përkufizime**

*(Shtuar pika 6 me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*  
*(Shtuar pika 7 me ligjin nr.55/2012, datë10.5.2012)*

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kompensim” nënkupton shpërblimin e drejtë, sipas vlerës së tregut në momentin e njohjes së shpërblimit, të kryer sipas këtij ligji;
2. “Pronë” nënkupton një send të paluajtshëm, sipas përcaktimit në Kodin Civil;
3. “Subjekt i shpronësuar” nënkupton personat juridikë ose fizikë apo trashëgimtarët e tyre, prona e të cilëve është shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar ose e marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti;
4. “Tjetërsim” nënkupton kalimin e pronësisë ose kalimin e të drejtave të tjera reale nga një person fizik ose juridik te një tjetër, sipas Kodit Civil;
5. “Truall” nënkupton tokën që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të banuara në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kur qendra e banuar nuk ka vijë kufizuese, truall do të jetë sipërfaqja e tokës që zë objekti i ndërtuar mbi të dhe oborri funksional. Sipërfaqja e këtij të fundit llogaritet sa trefishi i sipërfaqes së objektit, por jo më shumë se 500 metra katrorë.
6. “Truall industrial” nënkupton sipërfaqen e tokës që ndodhet jashtë vijave kufizuese të qyteteve dhe qendrave të banuara, mbi të cilin janë ngritur objekte të përhershme ndërtimore për qëllime ekonomike ose që u shërbejnë funksionit të tyre.
7. Standarde ndërkombëtare të vlerësimit” nënkupton standardet e miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.

Neni 4  
**Përfundimet nga ky ligj**

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen:

- a) për pronat e përfuturuar si rezultat i zbatimit të ligjit nr.108, datë 29.8.1945 “Për reformën agrare”, me ndryshimet e mëvonshme;
- b) për shpronësimet kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe që përdoren për interesa publikë;
- c) për pronat që i janë dhuruar shtetit, veprim për të cilin ka dokumente zyrtare.

Neni 5  
**Prona e luajtshme**

Kthimi dhe kompensimi i pronës së luajtshme kryhet me ligj të veçantë.

**KREU II**  
**NJOHJA E SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE KTHIMI I PRONËS**

Neni 6  
**Njohja e së drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës**

*(Ndryshuar pika 1, shtuar pikat 1/a, 1/b, 1/c,1/ç, shtuar pika 2 me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006, neni 3, shfuqizuar pika 1/ç me ligjin nr. 10 186, datë 5.11.2009)*

1. Subjekteve të shpronësuar u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompensohet deri në 100 ha, në rast se subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) nuk kanë përfuturuar nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë

19.7.1991 “Për tokën”.

1/a. Kur subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) kanë përfituar tokë nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, atëherë sipërfaqja që kthehet apo kompensohet, sipas këtij ligji, llogaritet si diferencë ndërmjet pjesës, që do t’i takonte në kushtet e mospërfitimit nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me sipërfaqen, që secili prej tyre ka përfituar nga zbatimi i këtij ligji.

1/b. U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen subjekteve të shpronësuara, sipas kritereve të këtij ligji, edhe pasuritë e paluajtshme, toka me vendndodhje brenda territoreve turistike, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar.

1/c. Subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale-shkencore të instituteve kërkimore-shkencore dhe në çdo veprimtari tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore, por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre.

1/ç. Shfuqizuar

2. Subjektet e shpronësuara, pronat e të cilave janë përmytur nga ndërtimi i hidrocentraleve, trajtohen sipas dispozitave të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur kanë përfituar sipas ligjit “Për shpronësimet për interes publik”, toka do të vlerësohet si truall industrial.

3. Subjektet e shpronësuara dhe të kompensuara sipas ligjeve në fuqi kanë të drejtën e përfitimit nga ky ligj vetëm për pjesën e pronës së pakthyer ose të pakompensuar.

Neni 6/1

*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Pemëtaritë dhe vreshtat, pronë e subjekteve të shpronësuara, tokat e të cilave nuk janë regjistruar si toka bujqësore, do të konsiderohen si të tilla për qëllimet e kompensimit, sipas këtij ligji.

Pas verifikimit të pronësisë së tyre, ato do të konvertohen si toka bujqësore, mbi bazën e koeficientit që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

### **Pronat që nuk kthehen**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe ato që:

a) shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë;

b) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në shtojcën 1 të ligjit.

2. Në rast se pronat e paluajtshme, që përfshihen në pikën 1 të këtij neni, propozohen të tjetërsohen, ato u kalojnë subjekteve të shpronësuara kur këto nuk janë kompensuar.

3. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kompensohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

Neni 7/1

### **Prona të kthyera që i shërbejnë interesit publik**

*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Në të gjitha rastet kur marrëveshjet ndërkombëtare, planet e përgjithshme të zhvillimit urbanistik apo planet e zhvillimit ekonomik ose të turizmit parashikojnë, në pronat e kthyera sipas këtij ligji, ngritjen dhe zhvillimin e projekteve të investimit, në ekonomi a infrastrukturë, infrastukturën turistike, vepra ujore, energjetikë etj. nga shteti ose të tretë, në shërbim apo në interes publik, subjektet

e shpronësuar dhe zhvilluesi i interesuar për investim, në varësi të formës juridike ku mbështetet zhvillimi i projektit, mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktore, me qëllim realizimin e investimit.

2. Kur subjektet e shpronësuar dhe zhvilluesit e investimit nuk përfundojnë brenda një afati normal negociatash nënshkrimin e marrëveshjeve respektive të kalimit apo posedimit të ligjshëm të pasurisë, Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi, vendos kompensimin e subjektit të shpronësuar, sipas çmimit të tregut për sipërfaqet ku do të zhvillohet projekti.

Subjekti i shpronësuar dhe zhvilluesi i investimit i zhvillojnë negociatat, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, në kushtet e tregut.

Neni 8

### **Trualli**

*(Shfuqizuar pikat 2 dhe 4 me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Në rastin kur trualli u është tjetërsuar personave të tretë dhe mbi të nuk janë ngritur ndërtesa të përhershme dhe të ligjshme, ai u kthehet subjekteve të shpronësuar, ndërsa shteti u kthen të tretëve vlerën, sipas çmimit të blerjes të shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

2. Shfuqizuar.

3. Në rastet e ndërtimeve mbi truall, të bëra para datës 10.8.1991, për të cilat nuk është regjistruar pronësia e truallit, ai që ka në pronësi ndërtesën detyrohet të paguajë vlerën fillestare të truallit, sipas nenit 10 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” të shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

4. Shfuqizuar.

Neni 8/1

### **Trualli i zënë me ndërtime në pronësi të shtetit**

*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Në ndryshim nga formulimi i nenit 7, u kthehet apo u kompensohet subjekteve të shpronësuar trualli privat, mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit:

a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit, sipas këtij ligji, shteti detyrohet t’i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim, sipas tarifave që zbaton për dhënien me qira të trojeve shtetërore të tretëve.

b) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet janë në përdorim të të tretëve, në bazë të një kontrate qiraje, koncesioni ose enfiteoze mbi truallin ku ngrihet ndërtesa apo vetë ndërtesën, veprohet:

i) kur investimi i kryer është mbi 150 për qind të vlerës së truallit, subjekti kontraktues i paguan shtetit, brenda 6 muajve, vlerën e truallit me çmimet e tregut. Shteti ia paguan menjëherë vlerën e truallit pronarit të tokës. Në rast se subjekti kontraktues nuk paguan vlerën e truallit brenda afatit të mësipërm, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili, deri në përfundim të kontratës, merr nga shteti edhe qiranë e vendosur në kontratë. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes;

ii) kur investimi i kryer është nën 150 për qind të vlerës së truallit, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili merr nga shteti, deri në përfundim të kontratës, edhe qiranë e truallit që paguan subjekti sipas kontratës. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes së objektit.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioneve shtetërore nuk u lejohet të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo përdorim objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private, përveç rasteve kur kontratat i shërbejnë realizimit të interesave publikë, të përcaktuar në nenin 7/1 të këtij ligji.

Në rast se objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private transferohen në pronësi apo në administrim të një institucioni tjetër shtetëror, e drejta e parablerjes nuk shuhet.

Neni 8/2

*(Shtuar me ligjin nr.10 095, datë 12.3.2009)*

Për tokat e dhëna në përdorim, me qira ose në ndonjë formë tjetër, shoqërive tregtare, ku shteti zotëron pjesë të kapitalit ose aksione, për zhvillimin e veprimtarisë së tyre veprohet si më poshtë:

a) Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, nga sipërfaqja e tokës së dhënë ka të drejtë t'ia shesë shoqërisë, me çmim tregu, sipërfaqen e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa sipërfaqja tjetër, nëse ka të tillë, i kthehet fizikisht subjektit të shpronësuar.

Kur toka e shitur i është njohur subjektit të shpronësuar, të ardhurat nga shitja i kalojnë atij.

Kur toka ka qenë dhe është në pronësi të shtetit, të ardhurat nga shitja kalojnë në fondin e kompensimit.

b) Nëse shoqëria refuzon blerjen e tokës, brenda afatit të përcaktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, toka i kthehet fizikisht pronarit të shpronësuar, kur ka të tillë dhe marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë e subjektit rregullohen sipas legjislacionit civil shqiptar.

c) Subjektet e shpronësuara, në marrëveshje me shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mund të kompensohen me tokën që këto shoqëri vendosin të blejnë, duke pasur parasysh vlerën e tokës që ka prona e njohur e këtyre subjekteve, si dhe vlerën e tokës që ka në përdorim shoqëria. Marrëveshja ndërmjet subjekteve të shpronësuara dhe shoqërisë depozitohet në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe ekzekutohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Këshilli i Ministrave harton procedurat e realizimit të kompensimit të parashikuar në këtë paragraf.

Neni 9

#### **Banesat**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 4.4.2007)*

Neni 10

#### **Prona që nuk përdoret më për interesa publikë**

Kur një shpronësim është bërë për një interes publik dhe Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave vërteton se prona e paluajtshme nuk përdoret më për këtë qëllim, ajo i kthehet subjektit të shpronësuar, kurse subjekti i shpronësuar, kur është shpërblyer, i kthen shtetit shpërblimin e marrë.

### **KREU III**

#### **KOMPENSIMI I PRONËS**

Neni 11

#### **Format e kompensimit**

*(Shtuar pika a/1, shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Për pronat e përcaktuara në këtë ligj, për të cilat është i pamundur kthimi fizik, shteti kompenson subjektet e shpronësuara me një ose më shumë nga format e mëposhtme:

a) me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit;

a/1) me pasuri të paluajtshme publike në zonat, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;

b) me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit;

c) me aksione në shoqëri me kapital shtetëror ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të

barabartë me pronën e paluajtshme;

ç) me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit;

d) me të holla.

2. Shfuqizuar.

3. Shpërblimi për efekt kompensimi nuk i nënshtrohet asnjë takse, tatimi ose ndalese.

#### Neni 12

##### **Vendndodhja e kompensimit fizik**

*(Ndryshuar fjalia e parë dhe e dytë me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Kompensimi fizik, sipas shkronjave “a”, “a/1” dhe “b” të nenit 11 të këtij ligji, bëhet edhe jashtë kufijve territorialë të qarkut, ku ndodhet prona e paluajtshme. Këshilli i Ministrave miraton kriteret dhe procedurat për caktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik. Për kryerjen e kompensimit fizik përparësi kanë pronat publike, brenda zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, të përcaktuara në mbështetje të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

Trojet e dhëna me kompensim në zona turistike duhet të përdoren vetëm në përputhje me masterplanin për zhvillimin e turizmit dhe planet rregulluese respektive të territorit, të miratuara në zbatim të tij. Sipërfaqet e caktuara për kompensim shpallen publikisht në Fletoren Zyrtare, duke bërë të ditur si kategoritë, ashtu edhe vlerat e tyre.

#### Neni 13

##### **Vlerësimi i pronës**

*(Shtuar fjali në fund të pikës 1 me ligjin nr.10 308, datë 22.7.2010)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012)*

1. Vlera e pronës që kompensohet nxirret bazuar në çmimin e tregut, llojin e pasurisë dhe qëllimin e përdorimit të saj, sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Procesit të vlerësimit të pronës, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen:

a) toka;

b) objektet ndërtimore.

Në kategorinë e tokës përfshihen toka bujqësore, toka pyjore, pyjet, livadhet dhe kullotat, tokat e pafrytshme, si dhe trualli, pavarësisht masës dhe qëllimit publik apo privat të përdorimit të tij.

Në kategorinë e objekteve ndërtimore përfshihen ndërtesat dhe strukturat inxhinierike, që e gëzojnë këtë cilësi sipas legjislacionit në fuqi.

Treguesit bazë të vlerës së pronës caktohen të veçanta për tokën dhe objektet ndërtimore. Kur një pronë është bashkim i tokës me objektin ndërtimor, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet.

3. Metodologjia për vlerësimin e pronës, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Baza e të dhënave shtetërore të vlerësimit të pasurive të paluajtshme krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcaktohen:

a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;

b) të dhënat parësore dhe dytësore;

c) dhënësin/dhënësit e informacionit;

ç) ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave;

d) niveli i aksesimit për subjektet e interesuara.

Neni 14  
**E drejta e parablerjes**  
*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

1. Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuara kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen. E drejta e parablerjes regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për të drejtën e parablerjes në privatizimin e objekteve.

2. Subjektet e shpronësuara kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta e parablerjes përkundrejt kompensimit, sipas nenit 11 të këtij ligji.

**KREU IV**  
**ORGANET SHTETËRORE PËR PROCESIN E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Neni 15  
**Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**  
*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009)*  
*(Shfuqizuar gërmat c, ç, d dhe dh të pikës 1, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010)*

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik, në vijim AKKP, me qendër në Tiranë. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe përbush këto përgjegjësi:

a) Përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohjen, kthimin e njohjen e së drejtës së kompensimit, të depozituara në ish-zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe, për të cilat nuk është marrë vendim nga këto zyra, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar:

i) tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi;

ii) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2 të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në nënndarjen “ii” më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të trajtimit të kërkesës për:

- rrëzimin e kërkesës;

- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kthimin a kompensimin e pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji.

b) Përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit;

- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

e) Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

ë) Verifikon dhe llogarit detyrimet financiare, që i lindin shtetit për subjektet e shpronësuara ose për të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

f) Depoziton për regjistrim aktet e njohjes, të kthimit ose kompensimit të pronave dhe të të drejtave reale, të lidhura me to, në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. AKKP-ja, për ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në këtë nen, bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton sanksionet për shkelje të afateve dhe mospërgjegje me përgjegjshmëri nga institucionet që kanë në administrim pronën dhe informacionin ligjor për të.

3. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, sipas këtij neni, duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkuara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv.

4. Ngarkohen zyrat e shërbimit përbarimor për ekzekutimin e vendimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

5. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AKKP-së, procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, si dhe procedurat e afatet e komunikimit me institucionet shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Tarifat për procedurat e kthimit dhe kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Financave.

#### Neni 16

#### **Shqyrtimi i vendimit kryesisht**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar pika 1 dhe pika 3, shtuar pika 4 me ligjin nr.9684, datë 6.2.2007)*

*(Ndryshuar me ligjin nr. nr.10207, datë 23.12.2007)*

*(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010)*

#### Neni 17

#### **Afati**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9898, datë 10.4.2008)*

*(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009)*

1. Subjektet e shpronësuara, për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të depozitojnë kërkesa të reja deri në datën 31 dhjetor 2008. Në rast se subjekti i shpronësuar për shkaqe të përlegjura nuk ka arritur të depozitojë kërkesën, ka të drejtë të rivendosë afatin nëpërmjet gjykatës.

2. AKKP-ja shqyrton kërkesën për kompensim jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit të saj.

Kërkesa e subjektit të shpronësuar depozitohet drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet postës dhe evidentohet në regjistrin e protokollit të institucionit. Subjekti pajiset me vërtetimin e regjistrimit të kërkesës.

I njëjti afat dhe e njëjta procedurë janë të vlefshme edhe për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësive, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 15.

3. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk do të trajtojë



me vendim asnjë kërkesë që mbështet pretendimin e vet vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës mbi pasurinë e paluajtshme, në kuptim të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha aplikimet e mbështetura mbi vërtetim fakti juridik do t'u kthehen subjekteve brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre.

Ekzekutimi i vendimit për kompensim financiar kryhet brenda 6- mujorit të parë të çdo viti financiar. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat dhe kriteret për trajtimin e vendimeve të kompensimit financiar.

Neni 18

**Ankimi**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, me ligjin nr.9684, datë 6.2.2007)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009)*

Kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

*(Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005)*

*(Shfuqizuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Neni 20

**Transferimi i arkivit, logjistikës dhe mjeteve të punës**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009)*

Veprimtaria e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe përfundon 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç zyrës së arkivit. Arkivi, mjetet e punës dhe logjistika e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, krijuar dhe administruar sipas ligjit, inventarizohen dhe i transferohen në përgjegjësi administrimi AKKP-së brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU V

**DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 21

**Transferimi i fondeve buxhetore të KSHKKP- së dhe komisioneve vendore**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006, neni 19)*

Fondet buxhetore, të planifikuara për Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe komisionet vendore të kthimit të pronave në qarqe, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, transferohen në llogari të AKKP-së. Përjashtim bën vetëm fondi i pagës për punonjësin që kryen dorëzimin e dosjeve.

Neni 22

**Vendimet e mëparshme**

1. Në rast se në dosjet e depozituara në komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave, të ngritura sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”,

ekziston dokumentacioni i nevojshëm për vërtetimin e pronësisë për pronën që do të përfitohet sipas këtij ligji, subjekti i shpronësuar paraqet vetëm kërkesën me shkrim për njohjen, kthimin ose kompensimin e pjesës së mbetur të pronës së paluajtshme. Vendimet e dhëna në bazë të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë ose me troje të ish-pronarëve të tokave bujqësore, livadheve, kullotave, tokave pyjore dhe pyjeve” që nuk janë realizuar, konsiderohen të vlefshme për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe komisioni përcakton nëse është i mundur kthimi i pronës së paluajtshme apo kompensimi i saj.

2. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave rifillon në mënyrën, formën dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 22/1

*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Kudo në ligj emërtimet “Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” dhe “Komisioni vendor i kthimit dhe kompensimit të pronave” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” dhe “Zyra rajonale e AKKP-së në qark.

Neni 23

#### **Fondi i kompensimit**

*(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1, me ligjin nr.10 095, datë 12.3.2009)*

1. Për zbatimin e kompensimit financiar, krijohet Fondi i Kompensimit të Pronave. Ky fond përbëhet nga të ardhurat buxhetore, nga të ardhurat e krijuara nga ky ligj të ardhurat e realizuara nga shitja me ankand e pasurive shtetërore, për të cilat nuk ka vendim të dhënë nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe të ardhura nga donatorë të ndryshëm.

2. Duke filluar nga viti 2005 dhe për një periudhë 10-vjeçare rresht, Kuvendi, për propozimin e Këshillit të Ministrave, cakton Fondin e Kompensimit, i cili administrohet nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kompensimin në të holla të subjekteve të shpronësuara. Për periudhën nga njohja e së drejtës së pronësisë deri në marrjen e shpërblimit në formën e kompensimit në të holla, subjekti i shpronësuar përfiton edhe interesin bankar, sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.

3. Bazuar në vendimet e komisioneve vendore ose të gjykatave dhe sipas një radhe të përcaktuar nga vetë ai, Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ndan Fondin për Kompensimin në mënyrë proporcionale.

Neni 24

#### **Afati i përfundimit të procesit**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9388, datë 4.5.2005)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9898, datë 10.4.2008)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10207, datë 23.12.2009)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.49/2014, datë 8.5.2014)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.47/2015, datë 8.5.2014)*

Afati për procesin e njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave të paluajtshme dhe afati për kryerjen e procesit të pagesës së kompensimit, të përcaktuar në nenin 23, të këtij ligji, është data 30.10.2015.

Neni 25

**Përdorimi i dokumenteve shtetërore**

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, institucionet shtetërore vënë në dispozicion të subjekteve të shpronësuara dhe komisioneve shtetërore, kundrejt shpërblimit, kopje të të gjitha dokumenteve që disponojnë.

Neni 26

**Ruajtja e dokumentacionit**

Dokumentacioni i procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave ruhet sipas legjislacionit në fuqi për arkivat. Me përfundimin e procesit, sipas nenit 24 të këtij ligji, ky dokumentacion i dorëzohet Arkivit Qendror të Shtetit.

Neni 27

**Kontrolli**

Kontrolli ekonomik dhe financiar i veprimtarisë së Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe i komisioneve vendore kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të paktën një herë në gjashtë muaj. Përfundimet e kontrolleve bëhen kurdoherë publike.

Neni 28

**Fondi i pasurive të paluajtshme për kompensim fizik**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.9898, datë 10.4.2008)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.10308, datë 22.7.2010)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.49/2014, datë 10.5.2012)*

*(Ndryshuar me ligjin nr.47/2015, datë 10.5.2012)*

Përveç fondit financiar të kompensimit, të parashikuar nga neni 23 i këtij ligji, krijohet fondi i pasurive të paluajtshme për kompensim fizik. Brenda datës 30.10.2015, Këshilli i Ministrave miraton fondin e pronave pasuri të paluajtshme shtetërore që vihen në dispozicion për kompensim fizik, sipas shkronjave “a”, “a/1” dhe “b” të nenit 11 të këtij ligji, si dhe mënyrat e vendosjes së këtij fondi në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Neni 28/1

**Dispozita kalimtare**

*(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)*

Për pasuri të paluajtshme, mbi të cilat janë ngritur nga të tretë objekte pa leje në kundërshtim me ligjin “Për urbanistikën”, kthimi fizik nuk zbatohet pa përfunduar afatet ligjore të parashikuara për legalizimin e objekteve në zona informale dhe objekte të tjera informale me vendndodhje brenda territoreve formale. Në përfundim të afatit ligjor të parashikuar për procesin e legalizimit, zbatohet, aty ku është e mundur, kthimi fizik i pronës së paluajtshme, ndërsa pjesa tjetër kompensohet në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Në çdo kohë, subjektit të shpronësuar ose subjektit që është zhveshur arbitrarisht nga pronësia i lind e drejta që, përpara përfundimit të afatit të parashikuar për mbylljen e procesit të legalizimit, të

heqë dorë nga e drejta e kthimit fizik të pasurive të zëna me këto ndërtime kundrejt kompesimit, sipas dispozitave të nenit 11 të këtij ligji.

Ky kufizim nuk i shtrin efektet e tij për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë vënë në dispozicion të të tretëve me qira, enfiteozë, koncesion etj. nga shteti, me gjithë përmirësimet ose ndërtimet e kryera në to. Për të gjitha këto pasuri të paluajtshme zbatohet menjëherë rregullimi ligjor i parashikuar në pikën 1 shkronja “b” të nenit 8/1 të këtij ligji.

Neni 28/2

**Verifikimi i ligjshmërisë së tjetërsimeve**  
(Shtuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006)

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të verifikojë procesin e kalimit në përdorim ose në pronësi pa kundërshtim të pasurisë së paluajtshme tokë, sipas akteve ligjore të paraqitura në shtojcën 1/1 të këtij ligji, familjeve ose anëtarëve të ndërmarrjeve bujqësore apo kooperativave bujqësore, personave që kanë themeluar ish-ndërmarrje bujqësore, ish-punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore me banim në qytet ose specialistëve të bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e organizon këtë proces nëpërmjet drejtorive rajonale të bujqësisë në 12 qarqe.

2. Procesi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë. Verifikimi mbështetet në dokumente zyrtare që administrojnë vetë ministria, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arkivi i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe çdo ent tjetër publik ose privat dhe, sipas rastit, në verifikime në vend.

Dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet publike për llogari të këtij procesi regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe përjashtohen nga pagesat për taksë pulle apo tarifë shërbimi.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përfundon procesin e verifikimit në të gjithë territorin e vendit brenda datës 30 qershor 2008.

Në përputhje me rezultatet e verifikimit, Këshilli i Ministrave përcakton masat administrative për rivendosjen e ligjshmërisë në vend.

Neni 28/3

(Shtuar me ligjin nr.9684, datë 6.2.2007, neni 3)

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, për vendimet e ish-komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të ankimuar dhe të depozituara në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para krijimit të AKKP-së, të mbetura pa shqyrtuar, shprehet me vendim brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 28/4

**Koordinimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës**  
(Shtuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012, neni 5)

1. Ministria e Drejtësisë, në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtaritë e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorisë së Administrimit të Shitjes së Pronës Publike, Komisionit Qeveritar të Tokës, Avokaturës së Shtetit, si dhe të çdo institucioni tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë

informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe të raportojë arsyet e mospërbushjes së një mase apo rekomandimi të kërkuar.

2. Ministria e Drejtësisë i ushtron këto përgjegjësi nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, e cila:

a) përgatit rekomandime për masat ligjore dhe organizative mbi çështjet e të drejtave të pronësisë, duke mbikëqyrur procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe procesin e zbatimit të masave strategjike të miratuara;

b) harton programe, analiza tekniko-ligjore, studime për efektivitetin dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme ligjore dhe ekzekutive për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë;

c) mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon punët e saj me institucionet e tjera shtetërore, të përfshira në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave;

ç) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe transmetimin e ndërsjellë të informacionit dhe dokumentacionit midis institucioneve të tjera shtetërore për përditësimin e të dhënave të tyre në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës;

d) ndjek dhe realizon çdo detyrë tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

3. Këshilli i Ministrave, me vendim, cakton rregulla të hollësishme për procedurën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e tjera shtetërore.

4. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Koordinimit është pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë, që miratohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Rregulla të hollësishme për ushtrimin e veprimtarive nga Drejtoria e Koordinimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 29

#### **Aktet nënligjore**

Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të tij.

Neni 30

#### **Shfuqizime**

Ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me ndryshimet e mëvonshme, ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve”, dekreti nr.1254, datë 19.10.1995 “Për kompensimin e ish-pronarëve të tokës bujqësore dhe jobujqësore dhe të trojeve të zëna, me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara”, neni 10 i ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, shkronja “ç” e nenit 7 dhe neni 13 të ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 31

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

#### **(Dispozitë kalimtare e parashikuar me ligjin nr.55/2012, datë 10.5.2012, neni 6)**

1. Çdo dispozitë ligjore dhe çdo vendim në zbatim të saj, që rregullon vlerësimin e pronës që i kompensonet subjekteve të shpronësuara, shfuqizohet.

2. Vlerësimi i pronës që i kompensohet subjekteve të shpronësuara, deri në miratimin e akteve nënligjore për vlerësimin e pronës, sipas këtij ligji, rregullohet sipas dispozitave të mëparshme.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

#### SHTOJCA 1

1. Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.
2. Ligji nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.
3. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 378, datë 2.12.1992 “Për faljen e studiove të punës piktorëve dhe skulptorëve”.
4. Ligji nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.
5. Ligji nr.7665 datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.
6. Ligji nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.
7. Ligji nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokave”.
8. Ligji nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”.

#### SHTOJCA 1/1

Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar;  
Ligji nr.7983, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”;  
Ligji nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa kundërshpërblim të tokës bujqësore”;  
Ligji nr.8312, datë 26.3.1993 “Për tokat bujqësore të pandara”;  
Ligji nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore pyjore, livadheve dhe kullotave”;  
Vendimi nr.452, datë 17.10.1992 “për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”

#### **Ligj nr.9235, datë 29.7.2004**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, faqe 3934*

#### **Ligj nr.9388, datë 4.5.2005 shpallur me dekretin nr.4594, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, faqe 1603*

#### **Ligj nr.9583, datë 17.7.2006 shpallur me dekretin nr.5001, datë 28.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81, faqe 2786*

#### **Ligj nr.9684, datë 6.2.2007 shpallur me dekretin nr.5203, datë 8.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 180.*

#### **Ligj nr.9898, datë 10.4.2008 shpallur me dekretin nr.5690, datë 29.4.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.62, faqe 2736*

#### **Ligj nr.10 095, datë 12.3.2009**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.53, faqe 2479*

#### **Ligj nr.10 207, datë 23.12.2009 shpallur me dekretin nr.6383, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.194, faqe 8573*

**Ligj nr.10 308, datë 22.7.2010**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.1127, faqe 8573*

**Ligj nr.55/2012, datë 10.5.2012 shpallur me dekretin nr. 7495, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, faqe 3017*

**Ligj nr.49/2014, datë 8.5.2014 shpallur me dekretin nr. 8575, datë 27.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, faqe 2705*

**Ligj nr.47/2015, datë 7.5.2015 shpallur me dekretin nr. 9107, datë 21.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.84, faqe 4405*

**Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 2.11.2005**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.91, faqe 2927*

**Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 4.4.2007**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.46, faqe 1177*

**Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81, faqe 4272*

**Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 6.10.2011**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, faqe 4272*

## **LIGJ**

**Nr. 9388, datë 4.5.2005**

### **PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në nenin 16 pika 2 rreshti i pestë, shprehja “brenda 6 muajve” ndryshohet në “brenda 18 muajve” dhe fjala “Komisioni” zëvendësohet me fjalën “Komiteti”.

**Neni 2**

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shprehja “brenda 1 viti” ndryshohet në “brenda 2 vjetëve”.
2. Në pikën 2, shprehja “brenda 45 ditëve” ndryshohet në “brenda 3 muajve”.

**Neni 3**

Në nenin 24, shprehja “deri në datën 31.12.2006” ndryshohet në “deri në datën 31.12.2007”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4594, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**L I G J**  
**Nr.9583, datë 17.7.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në fund të nenit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Fusha e veprimt të këtij ligji shtrihet edhe për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939 dhe që janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, datë 13.1.1945 “Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës” .”.

Neni 2

Në nenin 3 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Truall industrial” nënkupton sipërfaqen e tokës që ndodhet jashtë vijave kufizuese të qyteteve dhe qendrave të banuara, mbi të cilin janë ngritur objekte të përhershme ndërtimore për qëllime ekonomike ose që u shërbejnë funksionit të tyre.” .

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 fjalët “deri në 60 ha dhe kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe” zëvendësohen me fjalët “deri në 100 ha, në rast se subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) nuk kanë përfituar nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën””.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/a, 1/b, 1/c dhe 1/ç me këtë përmbajtje:

“1/a. Kur subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) kanë përfituar tokë nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, atëherë sipërfaqja që kthehet apo kompensohet, sipas këtij ligji, llogaritet si diferencë ndërmjet pjesës, që do t'i takonte në kushtet e mospërfitimit nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me sipërfaqen, që secili prej tyre ka përfituar nga zbatimi i këtij ligji.



1/b. U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen subjekteve të shpronësuara, sipas kritereve të këtij ligji, edhe pasuritë e paluajtshme, toka me vendndodhje brenda territoreve turistike, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar.

1/c. Subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale-shkencore të instituteve kërkimore-shkencore dhe në çdo veprimtari tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore, por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre.

1/ç. Në rastet kur në pronën e marrë me qira është ndryshuar destinacioni i objekteve të ndërtuara, për të cilën është rënë dakord për t’i përdorur për veprimtari të stimuluar, toka quhet e pazënë dhe i kthehet subjektit të shpronësuar.

Kur investimi është kryer mbi një tokë pronë publike, subjekti kontraktues i paguan shtetit brenda 6 muajve vlerën e trullit me çmimin e tregut. Të ardhurat e realizuara nga shitja përfshihen në fondin e kompensimit të pronave.”.

3. Në fund të pikës 2 shtohen fjalët “toka do të vlerësohet si truall industrial.”.

Neni 4

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Pemëtaritë dhe vreshtat, pronë e subjekteve të shpronësuara, tokat e të cilave nuk janë regjistruar si toka bujqësore, do të konsiderohen si të tilla për qëllimet e kompensimit, sipas këtij ligji.

Pas verifikimit të pronësisë së tyre, ato do të konvertohen si toka bujqësore, mbi bazën e koeficientit që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 5

Neni 7 të ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

#### **Pronat që nuk kthehen**

1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe ato që:
  - a) shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë;
  - b) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në shtojcën 1 të ligjit.
2. Në rast se pronat e paluajtshme, që përfshihen në pikën 1 të këtij neni, propozohen të tjetërsohen, ato u kalojnë subjekteve të shpronësuara kur këto nuk janë kompensuar.
3. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kompensohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

Neni 6

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

### **Prona të kthyera që i shërbejnë interesit publik**

1. Në të gjitha rastet kur marrëveshjet ndërkombëtare, planet e përgjithshme të zhvillimit urbanistik apo planet e zhvillimit ekonomik ose të turizmit parashikojnë, në pronat e kthyera sipas këtij ligji, ngritjen dhe zhvillimin e projekteve të investimit, në ekonomi a infrastrukturë, infrastukturën turistike, vepra ujore, energjetikë etj. nga shteti ose të tretë, në shërbim apo në interes publik, subjektet e shpronësuara dhe zhvilluesi i interesuar për investim, në varësi të formës juridike ku mbështetet zhvillimi i projektit, mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktore, me qëllim realizimin e investimit.

2. Kur subjektet e shpronësuara dhe zhvilluesit e investimit nuk përfundojnë brenda një afati normal negociatash nënshkrimin e marrëveshjeve respektive të kalimit apo posedimit të ligjshëm të pasurisë, Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi, vendos kompensimin e subjektit të shpronësuar, sipas çmimit të tregut për sipërfaqet ku do të zhvillohet projekti.

Subjekti i shpronësuar dhe zhvilluesi i investimit i zhvillojnë negociatat, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, në kushtet e tregut.”.

Neni 7

Në nenin 8 pikat 2 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 8

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

### **Trualli i zënë me ndërtime në pronësi të shtetit**

1. Në ndryshim nga formulimi i nenit 7, u kthehet apo u kompensohet subjekteve të shpronësuara trualli privat, mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit:

a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit, sipas këtij ligji, shteti detyrohet t'i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim, sipas tarifave që zbaton për dhënie me qira të trojeve shtetërore të tretëve.

b) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet janë në përdorim të të tretëve, në bazë të një kontrate qiraje, koncesioni ose enfiteoze mbi truallin ku ngrihet ndërtesa apo vetë ndërtesën, veprohet:

i) kur investimi i kryer është mbi 150 për qind të vlerës së truallit, subjekti kontraktues i paguan shtetit, brenda 6 muajve, vlerën e truallit me çmimet e tregut. Shteti ia paguan menjëherë vlerën e truallit pronarit të tokës. Në rast se subjekti kontraktues nuk paguan vlerën e truallit brenda afatit të mësipërm, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili, deri në përfundim të kontratës, merr nga shteti edhe qiranë e vendosur në kontratë. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes;

ii) kur investimi i kryer është nën 150 për qind të vlerës së truallit, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili merr nga shteti, deri në përfundim të kontratës, edhe qiranë e truallit që paguan subjekti sipas kontratës. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes së objektit.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioneve shtetërore nuk u lejohet të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo përdorim objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private, përveç rasteve kur kontratat i shërbejnë realizimit të interesave publikë, të përcaktuar në nenin 7/1 të këtij ligji.

Në rast se objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private transferohen në pronësi apo në administrim të një institucioni tjetër shtetëror, e drejta e parablerjes nuk shuhet.”.

## Neni 9

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 9 Banesat

1. Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilat u janë dhënë me qira qiramarrësve nga shteti para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe që shfrytëzohen për nevoja strehimi, kalojnë në posedim të subjekteve të shpronësuara, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:

- a) qiramarrësit kanë plotësuar nevojat e tyre për strehim në çfarëdo mënyre tjetër të ligjshme;
- b) subjektet e shpronësuara u ofrojnë qiramarrësve strehim në sipërfaqe jo më të vogël dhe me kushte të përafërta me strehimin që kanë në përdorim, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, derisa qiramarrësit të plotësojnë nevojat e tyre për strehim në njërën nga mënyrat e tjera të parashikuara në këtë nen;
- c) qiramarrësit nënshkruajnë kontratën e kredisë me institucionin financiar, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;
- ç) qiramarrësit përfitojnë strehim ose truall, sipas pikës 3 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

2. Në zbatim të kërkesave të shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kontrata e përcaktuar në pikën 1 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” duhet të lidhet midis Ministrit të Financave, ministrit që mbulon strehimin dhe institucionit që jep dhe menaxhon kredinë, brenda datës 31 dhjetor 2006. Për qiramarrësit që përfitojnë kredi, sipas pikës 2 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004, kontrata duhet të përmbajë edhe fondin limit të financimit. Fondi limit fiksohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, që caktojnë koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K”, mbi të cilin operon Enti Kombëtar i Banesave.

3. Lista e të pastrehëve, qiramarrës në banesat pronë e subjekteve të shpronësuara, që trajtohen sipas shkronjave “c” dhe “ç” dhe fondi limit, sipas pikës 2 të këtij neni, hartohen nga Enti Kombëtar i Banesave, në bazë të dokumentacionit të njësisë të qeverisjes vendore dhe të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pas verifikimit në terren të të dhënave dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave jo më vonë se data 31 tetor 2006.

4. Personat e pastrehë, qiramarrës në banesat pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilët brenda datës 31 dhjetor 2008 nuk lidhin kontratën sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, apo që deri në këtë datë nuk kanë plotësuar nevojat e tyre për strehim, sipas çdonjërit nga rastet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij neni, humbasin të drejtën e posedimit të ligjshëm të banesës dhe trajtohen në bazë të programeve sociale të strehimit, sipas nenit 4 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Subjekti i shpronësuar përfiton të drejtën e posedimit të ligjshëm të banesës në pronësi të tij.

5. Qiraja e banesave të zëna nga personat e pastrehë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, indeksohet bazuar në të dhënat e INSTAT-it për rritjen vjetore të çmimeve dhe pagave dhe synon mbulimin e shpenzimeve lidhur me koston e pronarit për mirëmbajtje dhe miradministrim të banesës. Në çdo rast, qiraja vjetore e indeksuar nuk mund të tejkalojë 10 për qind të koston minimale fiskale, që llogaritet nga administrata tatimore për efekt TVSH-je.

Indeksi i qirasë, sipas kësaj pike, bëhet nga Këshilli i Ministrave për çdo vit kalendarik. Për vitin e parë të hyrjes në fuqi të këtij ligji, çmimi i indeksuar zbatohet duke filluar nga data 1 korrik.

## Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:  
“a/1) me pasuri të paluajtshme publike në zonat, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;”.
2. Pika 2 shfuqizohet.

## Neni 11

Në nenin 12, fjalia e parë dhe e dytë ndryshohen si më poshtë:

“Kompensimi fizik, sipas shkronjave “a”, “a/1” dhe “b” të nenit 11 të këtij ligji, bëhet edhe jashtë kufijve territorialë të qarkut, ku ndodhet prona e paluajtshme. Këshilli i Ministrave miraton kriteret dhe procedurat për caktimin e pronave, fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik. Për kryerjen e kompensimit fizik përparësi kanë pronat publike, brenda zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, të përcaktuara në mbështetje të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

Trojet e dhëna me kompensim në zona turistike duhet të përdoren vetëm në përputhje me masterplanin për zhvillimin e turizmit dhe planet rregulluese respektive të territorit, të miratuara në zbatim të tij.”.

## Neni 12

Në fund të pikës 1 të nenit 14 shtohen dy fjali me këtë përmbajtje:

“E drejta e parablerjes regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për të drejtën e parablerjes në privatizimin e objekteve.”.

## Neni 13

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 15

#### **Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

1. Për zbatimin e këtij ligji krijohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP), ka qendër në Tiranë dhe zyra rajonale në çdo qark. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe ka këto përgjegjësi:

- a) pranon kërkesat për kthim ose kompensim, sipas këtij ligji;
- b) shqyrton kërkesat dhe kontrollon vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin subjektet e shpronësuara dhe e ballafaqon atë me aktet ligjore, nënligjore ose vendimet gjyqësore, sipas nenit 2 të këtij ligji, që kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë nga shteti të pronës;
- c) verifikon dhe llogarit detyrimet financiare që lindin për shtetin, subjektin e shpronësuar ose të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;
- ç) u konfirmon të drejtën e pronësisë subjekteve të shpronësuara, duke lëshuar dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrën e kthimit ose të kompensimit të pronësisë, sipas modelit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

d) regjistron aktet e njohjes, kthimit ose kompensimit të pronave dhe të drejtat reale të lidhura me to në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. Për ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, AKKP-ja bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton procedurën dhe afatet e komunikimit ndërmjet institucioneve.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

#### Neni 14

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 16

#### **Përgjegjësitë e zyrave në qendër dhe në qarqe**

1. Zyra e AKKP-së në qendër udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji në zyrat rajonale të qarqeve, bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim, sipas mënyrës së parashikuar nga neni 11 i këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme të njohur për t'u kompensuar, si dhe shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark. Në zbatim të përgjegjësive të veta, për kompensimin dhe zgjidhjen e ankimeve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.

2. Zyrat rajonale të AKKP-së në qark kryejnë trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohje dhe kthim të pasurisë së paluajtshme për pasuritë me vendndodhje brenda territorit të qarkut. Drejtori i zyrës së qarkut nënshkruan vendimin për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin ose kompensimin e pasurisë dhe të drejta të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji. Në zbatim të përgjegjësive të veta, për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimin ose kompensimin, si dhe të drejta të tjera reale, drejtori i zyrës rajonale të AKKP-së në qark shprehet me vendim.

3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushin kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative për aktin administrativ. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk ankimohet nga kërkuesi, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përbarimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.”.

#### Neni 15

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 17

#### **Afati**

1. Subjektet e shpronësuara, për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të depozitojnë kërkesa të reja deri në datën 1 tetor 2007.

2. Zyra e AKKP-së në qendër shqyrton kërkesën për kompensim, jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit të saj. Në rast se zyra e AKKP-së në qendër e ka të pamundur të vendosë brenda këtij afati, ajo njofton subjektin e shpronësuar dhe, me vendim të arsyetuar, mund të shtyjë afatin për një periudhë jo më shumë se 30 ditë.

Kërkesa e subjektit të shpronësuar depozitohet drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet postës dhe

evidentohet në regjistrin e protokollit të institucionit. Subjekti pajiset me vërtetimin e regjistrimit të kërkesës.

I njëjti afat dhe e njëjta procedurë është e vlefshme edhe për shqyrtimin e kërkesës për njohje pronësie pranë zyrës së AKKP-së rajonale.

3. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk do të trajtojë me vendim asnjë kërkesë që mbështet pretendimin e vet vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës mbi pasurinë e paluajtshme, në kuptim të nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha aplikimet e mbështetura mbi vërtetim fakti juridik do t'u kthehen subjekteve brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre.

Ekzekutimi i vendimit për kompensim financiar kryhet brenda 6- muajorit të parë të çdo viti financiar. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat dhe kriteret për trajtimin e vendimeve të kompensimit financiar.”.

#### Neni 16

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 18

#### **Ankimi**

1. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ka të drejtë të bëjë ankim brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi në zyrën e AKKP-së në qendër, sipas pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji. Jo më vonë se 45 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit; ose

b) shfuqizmin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij.

Kundër vendimit për lënie në fuqi të vendimit të AKKP-së së zyrës rajonale, ankimi kryhet pranë gjykatës së rrethit në territorin e qarkut ku ka vendodhjen zyra rajonale e AKKP-së së qarkut dhe mbrojtja e interesave të AKKP-së kryhet nga zyra rajonale e AKKP-së së qarkut. Kur vendimi zgjidh çështjen në themel, ankimi kryhet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë dhe AKKP-ja përfaqësohet në gjykim nga zyra e AKKP-së në qendër.

2. Kundër vendimit të AKKP-së në qendër për kompensim të pronës, subjekti i shpronësuar ka të drejtë të bëjë ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi. AKKP-ja përfaqësohet në gjykim nga zyra e AKKP-së në qendër.”.

#### Neni 17

Neni 19 shfuqizohet.

#### Neni 18

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 20

#### **Transferimi i arkivit, logjistikës dhe mjeteve të punës**

Veprimtaria e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe e komisioneve në qarqe përfundon ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Arkivi, mjetet e punës dhe logjistika e Komitetit

Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe komisioneve vendore në qarqe, e krijuar dhe e administruar sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, transferohet në administrim të AKKP-së brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 19

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

**Transferimi i fondeve buxhetore të KSHKKP- së dhe komisioneve vendore**

Fondet buxhetore, të planifikuara për Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe komisionet vendore të kthimit të pronave në qarqe, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, transferohen në llogari të AKKP-së. Përjashtim bën vetëm fondi i pagës për punonjësin që kryen dorëzimin e dosjeve.”.

Neni 20

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 22/1

Kudo në ligj emërtimet “Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” dhe “Komisioni vendor i kthimit dhe kompensimit të pronave” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” dhe “Zyra rajonale e AKKP-së në qark”.”.

Neni 21

Në nenin 24, rreshti i dytë, afati i përfundimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave bëhet “31.6.2008”.

Neni 22

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

**Fondi i pasurive të paluajtshme për kompensim fizik**

Përveç fondit financiar të kompensimit, të parashikuar nga neni 23 i këtij ligji, krijohet fondi i pasurive të paluajtshme për kompensim fizik. Brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton fondin e pronave pasuri të paluajtshme shtetërore që vihen në dispozicion për kompensim fizik, sipas shkronjave “a”, “a/1” dhe “b” të nenit 11 të këtij ligji, si dhe mënyrat e vendosjes së këtij fondi në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”.

Neni 23

Pas nenit 28 shtohen nenet 28/1 dhe 28/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 28/1  
**Dispozita kalimtare**

Për pasuri të paluajtshme, mbi të cilat janë ngritur nga të tretë objekte pa leje në kundërshtim me ligjin “Për urbanistikën”, kthimi fizik nuk zbatohet pa përfunduar afatet ligjore të parashikuara për legalizmin e objekteve në zona informale dhe objekte të tjera informale me vendndodhje brenda territoreve formale. Në përfundim të afatit ligjor të parashikuar për procesin e legalizmit, zbatohet, aty ku është e mundur, kthimi fizik i pronës së paluajtshme, ndërsa pjesa tjetër kompensohet në përputhje me nenin 11 të këtij ligji.

Në çdo kohë, subjektit të shpronësuar ose subjektit që është zhveshur arbitrarisht nga pronësia i lind e drejta që, përpara përfundimit të afatit të parashikuar për mbylljen e procesit të legalizmit, të heqë dorë nga e drejta e kthimit fizik të pasurive të zëna me këto ndërtime kundrejt kompesimit, sipas dispozitave të nenit 11 të këtij ligji.

Ky kufizim nuk i shtrin efektet e tij për pasuritë e paluajtshme, të cilat janë vënë në dispozicion të të tretëve me qira, enfiteozë, koncesion etj. nga shteti, me gjithë përmirësimet ose ndërtimet e kryera në to. Për të gjitha këto pasuri të paluajtshme zbatohet menjëherë rregullimi ligjor i parashikuar në pikën 1 shkronja “b” të nenit 8/1 të këtij ligji.”.

Neni 28/2  
**Verifikimi i ligjshmërisë së tjetërsimeve**

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të verifikojë procesin e kalimit në përdorim ose në pronësi pa kundërshtim të pasurisë së paluajtshme tokë, sipas akteve ligjore të paraqitura në shtojcën 1/1 të këtij ligji, familjeve ose anëtarëve të ndërmarrjeve bujqësore apo kooperativave bujqësore, personave që kanë themeluar ish-ndërmarrje bujqësore, ish-punonjësve të ndërmarrjeve bujqësore me banim në qytet ose specialistëve të bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e organizon këtë proces nëpërmjet drejtorive rajonale të bujqësisë në 12 qarqe.

2. Procesi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë. Verifikimi mbështetet në dokumente zyrtare që administrojnë vetë ministria, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Arkivi i Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe çdo ent tjetër publik ose privat dhe, sipas rastit, në verifikime në vend.

Dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet publike për llogari të këtij procesi regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe përjashtohen nga pagesat për taksë pulle apo tarifë shërbimi.

3. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit përfundon procesin e verifikimit në të gjithë territorin e vendit brenda datës 15 mars 2007.

Në përputhje me rezultatet e verifikimit, Këshilli i Ministrave përcakton masat administrative për rivendosjen e ligjshmërisë në vend.”.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5001, datë 28.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**



## SHTOJCA 1/1

Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar;  
Ligji nr.7983, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”;  
Ligji nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi, pa kundërshtpërblim të tokës bujqësore”;  
Ligji nr.8312, datë 26.3.1993 “Për tokat bujqësore të pandara”;  
Ligji nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore pyjore, livadheve dhe kullotave”;  
Vendimi nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”.

### LIGJ

**Nr.9684, datë 6.2.2007**

### **PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

#### Neni 1

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zyra e AKKP-së në qendër ka këto përgjegjësi:

- a) udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji nga zyrat rajonale të qarqeve;
- b) bën shqyrtimin fillestar të kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 11 të këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme, të njohur për t’u kompensuar;
- c) shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve;
- ç) mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Në zbatim të përgjegjësiave të veta për kompensimin, zgjidhjen e ankimeve dhe shqyrtimin kryesisht të vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkuara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të

parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 e 2 të këtij neni nuk ankimohet ose nuk shqyrtohet nga Drejtori i AKKP-së brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përmbarimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Tarifat për procedurat e kthimit dhe të kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.”.

## Neni 2

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim në zyrën e AKKP-së në qendër. Jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit.

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ka të drejtë të shqyrtojë kryesisht, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark. Drejtori i Përgjithshëm shqyrton edhe vendimet e dhëna nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Pas shqyrtimit kryesisht ose shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij;
- c) kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së.”.

## Neni 3

Pas nenit 28/2 shtohet neni 28/3 me këtë përmbajtje:

### “Neni 28/3

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, për vendimet e ish-komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të ankimuara dhe të depozituara në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para krijimit të AKKP-së, të mbetura pa shqyrtuar, shprehet me vendim brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5203, datë 8.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr.9898, datë 10.4.2008**

**PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR  
KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Arian Madhi,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

**Neni 1**

Në nenin 17 pika 1, fjalët “deri në datën 1 tetor 2007” zëvendësohen me fjalët:  
“Deri në datën 31 dhjetor 2008. Në rast se subjekti i shpronësuar për shkaqe të përligjura nuk ka arritur të depozitojnë kërkesën, ka të drejtë të rivendosë afatin nëpërmjet gjykatës”.

**Neni 2**

Në nenin 24, fjalët “deri në datën 30.6.2008” zëvendësohen me fjalët “deri në datën 30.6.2009”.

**Neni 3**

Në nenin 28, fjalët “brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 31 dhjetor 2008 ”.

**Neni 4**

Në nenin 22/2 pika 3, fjalët “brenda datës 15 mars 2007” zëvendësohen me fjalët “brenda datës 30 qershor 2008”.

**Neni 5**

Pika 9 e shtojcës nr.1 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, hiqet.

**Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5690, datë 29.4.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**

**Nr. 10 095, datë 12.3.2009**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE  
KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

**Neni 1**

Pas nenit 8/1 shtohet neni 8/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 8/2

Për tokat e dhëna në përdorim, me qira ose në ndonjë formë tjetër, shoqërive tregtare, ku shteti zotëron pjesë të kapitalit ose aksione, për zhvillimin e veprimtarisë së tyre vepohet si më poshtë:

a) Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, nga sipërfaqja e tokës së dhënë ka të drejtë t’ia shesë shoqërisë, me çmim tregu, sipërfaqen e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa sipërfaqja tjetër, nëse ka të tillë, i kthehet fizikisht subjektit të shpronësuar.

Kur toka e shitur i është njohur subjektit të shpronësuar, të ardhurat nga shitja i kalojnë atij.

Kur toka ka qenë dhe është në pronësi të shtetit, të ardhurat nga shitja kalojnë në fondin e kompensimit.

b) Nëse shoqëria refuzon blerjen e tokës, brenda afatit të përcaktuar nga Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, toka i kthehet fizikisht pronarit të shpronësuar, kur ka të tillë dhe marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë e subjektit rregullohen sipas legjislacionit civil shqiptar.

c) Subjektet e shpronësuar, në marrëveshje me shoqëritë tregtare të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, mund të kompensohen me tokën që këto shoqëri vendosin të blejnë, duke pasur parasysh vlerën e tokës që ka prona e njohur e këtyre subjekteve, si dhe vlerën e tokës që ka në përdorim shoqëria. Marrëveshja ndërmjet subjekteve të shpronësuar dhe shoqërisë depozitohet në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe ekzekutohet nga Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Këshilli i Ministrave harton procedurat e realizimit të kompensimit të parashikuar në këtë paragraf.”.

**Neni 2**

Në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 23, pas fjalëve “nga të ardhurat e krijuara nga ky ligj” shtohen fjalët “të ardhurat e realizuara nga shitja me ankand e pasurive shtetërore, për të cilat nuk ka vendim të dhënë nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**LIGJ**  
**Nr.10 207, datë 23.12.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE  
KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13 pika 1, emërtimi “Zyra rajonale e AKKP-së në qark” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

**Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik, në vijim AKKP, me qendër në Tiranë. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe përmbush këto përgjegjësi:

a) Përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohjen, kthimin e njohjen e së drejtës së kompensimit, të depozituara në ish-zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe, për të cilat nuk është marrë vendim nga këto zyra, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar:

i) tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi;

ii) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2 të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në nënndarjen “ii” më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të trajtimit të kërkesës për:

- rrëzimin e kërkesës;

- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kthimin a kompensimin e pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji.

b) Përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

c) Përfundon shqyrtimin e ankimeve, që gjenden të depozituara në AKKP, nga Zyra e Avokaturës së Shtetit, për vendimet e njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Pas shqyrtimit e vlerësimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

ç) Përfundon shqyrtimin e verifikimit të vlefshmërisë ligjore të rasteve, për të cilat Drejtori i Përgjithshëm, me nismën e vet ose kryesisht, ka urdhëruar shqyrtimin e tyre. Pas vlerësimit e shqyrtimit, me nismën e vet ose kryesisht, të rastit të urdhëruar, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

d) Mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

dh) Vlerëson rekomandimet e autoriteteve të ngarkuara për monitorimin e zbatimit të ligjit.

Pas vlerësimit, sipas shkronjave “d” dhe “dh”, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

i) mosfillimin të procedimit të verifikimit të ligjshmërisë;

ii) fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe apo të vendimeve të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve në rrethe a bashki për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, duke vendosur:

- lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

e) Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

ë) Verifikon dhe llogarit detyrimet financiare, që i lindin shtetit për subjektet e shpronësuara ose për të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

f) Depoziton për regjistrim aktet e njohjes, të kthimit ose kompensimit të pronave dhe të të drejtave reale, të lidhura me to, në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. AKKP-ja, për ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në këtë nen, bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton sanksionet për shkelje të afateve dhe mospërgjegje me përgjegjshmëri nga institucionet që kanë në administrim pronën dhe informacionin ligjor për të.

3. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, sipas këtij neni, duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv.

4. Ngarkohen zyrat e shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e vendimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

5. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AKKP-së, procedurat e mbledhjes, të përpunimit

dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, si dhe procedurat e afatet e komunikimit me institucionet shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Tarifat për procedurat e kthimit dhe kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

### **Shqyrtimi i vendimit kryesisht**

1. AKKP-ja përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, të kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

2. AKKP-ja mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat, për shkak të shkeljeve flagrante të ligjit të kohës, i bëjnë këto vendime absolutisht të pavlefshme.”.

Neni 4

Në nenin 17, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. AKKP-ja shqyrton kërkesën për kompensim jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit të saj.

Kërkesa e subjektit të shpronësuar depozitohet drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet postës dhe evidentohet në regjistrin e protokollit të institucionit. Subjekti pajiset me vërtetimin e regjistrimit të kërkesës.

I njëjti afat dhe e njëjta procedurë janë të vlefshme edhe për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësive, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 15.”.

Neni 5

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

### **Ankimi**

Kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 6

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20  
**Transferimi i arkivit, logjistikës dhe mjeteve të punës**

Veprimtaria e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe përfundon 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç zyrës së arkivit. Arkivi, mjetet e punës dhe logjistika e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, krijuar dhe administruar sipas ligjit, inventarizohen dhe i transferohen në përgjegjësi administrimi AKKP-së brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 7

Në nenin 24, data “30.6.2009” zëvendësohet me datën “31.12.2011”.

Neni 8

Aktet nënligjore, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6383, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ  
Nr.10 207, datë 23.12.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE  
KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13 pika 1, emërtimi “Zyra rajonale e AKKP-së në qark” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

Neni 2

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:



## “Neni 15

### Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

1. Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik, në vijim AKKP, me qendër në Tiranë. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe përmbush këto përgjegjësi:

a) Përfundon brenda afatit ligjor shqyrtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohjen, kthimin e njohjen e së drejtës së kompensimit, të depozituara në ish-zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe, për të cilat nuk është marrë vendim nga këto zyra, duke kontrolluar, vlerësuar e konfirmuar:

i) tërësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi;

ii) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e shpronësuara, përmes ballafaqimit me aktet ligjore e nënligjore ose vendimet gjyqësore, në përputhje me nenin 2 të këtij ligji, të cilat kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.

Pas kontrollit, vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesave, sipas përcaktimeve të bëra në nënndarjen “ii” më sipër, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të trajtimit të kërkesës për:

- rrëzimin e kërkesës;  
- njohjen, sipas rastit, të së drejtës së pronësisë, kthimin a kompensimin e pasurisë dhe të të drejtave të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji.

b) Përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit.

Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit;  
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

c) Përfundon shqyrtimin e ankimeve, që gjenden të depozituara në AKKP, nga Zyra e Avokaturës së Shtetit, për vendimet e njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Pas shqyrtimit e vlerësimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- rrëzimin e ankesës;  
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

ç) Përfundon shqyrtimin e verifikimit të vlefshmërisë ligjore të rasteve, për të cilat Drejtori i Përgjithshëm, me nismën e vet ose kryesisht, ka urdhëruar shqyrtimin e tyre. Pas vlerësimit e shqyrtimit, me nismën e vet ose kryesisht, të rastit të urdhëruar, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, brenda 3 muajve nga nisja e procedimit të ankesës, vendos:

- lënien në fuqi të vendimit;  
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

d) Mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

dh) Vlerëson rekomandimet e autoriteteve të ngarkuara për monitorimin e zbatimit të ligjit.

Pas vlerësimit, sipas shkronjave “d” dhe “dh”, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

i) mosfillimin të procedimit të verifikimit të ligjshmërisë;

ii) fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së vendimeve të zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe apo të vendimeve të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve në rrethe a bashki për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, duke vendosur:

- lënien në fuqi të vendimit;
- shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

e) Pranon, shqyrton dhe vlerëson kërkesat për përfitimin e së drejtës së njohur për kompensim, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi.

ë) Verifikon dhe llogarit detyrimet financiare, që i lindin shtetit për subjektet e shpronësuara ose për të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

f) Depoziton për regjistrim aktet e njohjes, të kthimit ose kompensimit të pronave dhe të të drejtave reale, të lidhura me to, në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. AKKP-ja, për ushtrimin e përgjegjësive të përcaktuara në këtë nen, bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton sanksionet për shkelje të afateve dhe mospërgjegje me përgjegjshmëri nga institucionet që kanë në administrim pronën dhe informacionin ligjor për të.

3. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në zbatim të përgjegjësive për kompensimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankimeve, ndaj vendimeve për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, shprehet me vendim.

Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, sipas këtij neni, duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkuara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv.

4. Ngarkohen zyrat e shërbimit përmbartimor për ekzekutimin e vendimit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

5. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të AKKP-së, procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuara, si dhe procedurat e afatet e komunikimit me institucionet shtetërore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Tarifat për procedurat e kthimit dhe kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave.

### Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 16

#### **Shqyrtimi i vendimit kryesisht**

1. AKKP-ja përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, të kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

2. AKKP-ja mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe apo të ish-komisioneve vendore të rretheve a bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat, për shkak të shkeljeve flagrante të ligjit të kohës, i bëjnë këto vendime absolutisht të pavlefshme.”.

#### Neni 4

Në nenin 17, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. AKKP-ja shqyrton kërkesën për kompensim jo më vonë se 3 muaj nga data e regjistrimit të saj.

Kërkesa e subjektit të shpronësuar depozitohet drejtpërdrejt në institucion apo nëpërmjet postës dhe evidentohet në regjistrin e protokollit të institucionit. Subjekti pajiset me vërtetimin e regjistrimit të kërkesës.

I njëjti afat dhe e njëjta procedurë janë të vlefshme edhe për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësive, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 15.”.

#### Neni 5

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 18 **Ankimi**

Kundër vendimit të AKKP-së subjekti i shpronësuar ose Avokati i Shtetit ka të drejtë të bëjë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.”.

#### Neni 6

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 20 **Transferimi i arkivit, logjistikës dhe mjeteve të punës**

Veprimtaria e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe përfundon 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç zyrës së arkivit. Arkivi, mjetet e punës dhe logjistika e zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, krijuar dhe administruar sipas ligjit, inventarizohen dhe i transferohen në përgjegjësi administrimi AKKP-së brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

#### Neni 7

Në nenin 24, data “30.6.2009” zëvendësohet me datën “31.12.2011”.

#### Neni 8

Aktet nënligjore, që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

#### Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6383, datë 13.1.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 308, datë 22.7.2010**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004**  
**“PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 13, në fund të pikës 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Procesit të vlerësimit të pronës, si më sipër, i nënshtrohen, domosdoshmërisht, prona në formën e truallit, truallit industrial apo të çdo lloj sipërfaqeje tjetër toke.”.

**Neni 2**

Në nenin 15, paragrafi i parë i shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, si edhe të të drejtave të tjera reale të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të depozituara në AKKP nga subjektet e përcaktuara në ligj, brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit. Në rast se kërkesa paraqitet jashtë afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos mospranimin e kërkesës dhe njofton me shkrim kërkuesin për arsyen e refuzimit.”.

**Neni 3**

Pas nenit 16 shtohen nenet 16/1, 16/2, 16/3, 16/4, 16/5, 16/6 dhe 16/7 me këtë përmbajtje:

**“Neni 16/1**

**Rishikimi i vendimeve**

AKKP-ja, mbi bazën e një kërkesë për rishikim, shqyrton vendimet e ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, kur:

a) zbulohen rrethana të reja apo akte të reja shkresore që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

b) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, të kenë qenë apo të jenë deklaruar më pas të pavërteta me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilit është dhënë vendimi, të jenë lëshuar nga zyrtarë të dënuar penalisht për lëshimin e tyre;

ç) vendimi përmban një gabim material në fakt ose në ligj, bazuar në faktet e administruara në dosje gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

d) zyrtarët që kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit;

dh) vendimi është bazuar në një vendim gjyqësor ose akt të një organi tjetër, që ka ndikuar në marrjen e vendimit, dhe që më pas është prishur/ndryshuar.

#### Neni 16/2

#### **Vendimet që mund të rishikohen**

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të cilat nuk janë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë, apo për të cilat gjykata nuk ka dhënë një vendim themeli të formës së prerë.

#### Neni 16/3

#### **Subjektet që mund të kërkojnë rishikim**

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet nga:

a) çdo subjekt i shpronësuar, sipas përcaktimit të nenit 2 të këtij ligji, e drejta e njohjes, kthimit apo kompensimit të pronësisë i është cenuar nga vendimi që kërkohet të rishikohet;

b) personat juridikë publikë, nëse vendimi që kërkohet të rishikohet ka cenuar të drejtat pasurore shtetërore, të cilat, sipas ligjit të kohës, nuk i nënshtroheshin procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës;

c) Avokatura e Shtetit, bazuar në nenin 5 pika 1 shkronja “e” të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

#### Neni 16/4

#### **Afati i paraqitjes së kërkesës**

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 45 ditëve nga dita që kërkuesi ka marrë dijeni efektivisht për shkakun e rishikimit. Nëse vendimi kërkohet të rishikohet nga Avokatura e Shtetit, kërkesa duhet të paraqitet në çdo rast jo më vonë se pesë vjet nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit në rast se vendimi kërkohet të rishikohet. Avokatura e Shtetit mund të marrë dijeni për shkakun e rishikimit kryesisht nga ushtrimi i funksioneve të veta ose me njoftim nga institucionet shtetërore dhe entet publike.

#### Neni 16/5

#### **Kërkesa për rishikim**

1. Kërkesa paraqitet me shkrim dhe tregon vendimin që kërkohet të rishikohet, legjitimitimin e subjektit kërkues, shkakun për të cilin kërkohet rishikimi, aktet shkresore që mbështesin shkakun e rishikimit, datën e lindjes së shkakut të rishikimit dhe datën e marrjes dijeni efektivisht mbi shkakun e rishikimit të kërkuesit.

2. Kërkesës për rishikim i bashkëngjiten:

a) kopje e vendimit që kërkohet të rishikohet;

b) kopje të akteve shkresore që vërtetojnë shkakun e rishikimit;

c) kopje të akteve shkresore që vërtetojnë datën e marrjes dijeni efektivisht.

3. Kërkesa e paplotësuar me elementet e mësipërme kthehet për plotësim nga AKKP-ja. Në rast

se kërkesa nuk plotësohet brenda një afati 15-ditor, AKKP-ja vendos mospranimin e kërkesës, për shkak të mungesës së elementeve të domosdoshme të parashikuara nga ligji.

Neni 16/6

### **Procedura e verifikimit paraprak**

1. Brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës ose nga plotësimi i mangësive të kërkesës, AKKP-ja analizon:

- a) legjitimitimin e kërkuarit;
- b) afatin e paraqitjes së kërkesës për rishikim;
- c) nëse vendimi mund të rishikohet sipas nenit 16/2 të këtij ligji; dhe
- ç) nëse shkak i pretenduar për rishikim parashikohet në ligj.

Nëse edhe një prej këtyre kushteve nuk përmbushet, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos mospranimin e kërkesës për rishikim. Kundër vendimit për mospranimin e kërkesës për rishikim mund të bëhet ankim, sipas rregullave për ankimin ndaj akteve administrative.

2. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos sipas pikës 1 të këtij neni edhe kur kërkesa për rishikim është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtin shkak.

Neni 16/7

### **Shqyrtimi në themel dhe vendimmarrja**

1. Nëse nuk ekzistojnë kushtet e mosprimit të kërkesës për rishikim, të parashikuara në nenin 16/6, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së me vendim të ndërmjetëm vendos kalimin e çështjes për shqyrtim në themel. Afati për shqyrtimin në themel është 60 ditë. Në përfundim të shqyrtimit në themel të çështjes, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit;
- c) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes.

2. Nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim konstatohet se janë kushtet e nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit.

3. Procesi i shqyrtimit administrativ zhvillohet duke garantuar të drejtën për të dëgjuar të gjitha palët e interesuara.

4. Vendimet e dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim, duhet të plotësojnë të gjitha elementet e parashikuara në pikën 3 të nenit 15 të këtij ligji.

5. Kur vendimi nuk ankimohet brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ai përbën titull ekzekutiv.”.

Neni 4

Në nenin 28 afati “31 dhjetor 2008” zëvendësohet me afatin “31.12.2011”.

Neni 5

Nëse përpara çastit të hyrjes në fuqi të këtij ligji, kërkuar ka marrë dijeni për ekzistencën e shkaqeve për rishikimin e vendimit, sipas këtij ligji, afati i paraqitjes së kërkesës për rishikim është 45 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**LIGJ**  
**Nr. 55/2012**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9235, DATË 29.7.2004 “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. “Standarde ndërkombëtare të vlerësimit” nënkupton standardet e miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme.”.

Neni 2

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 13**  
**Vlerësimi i pronës**

1. Vlera e pronës që kompensohet nxirret bazuar në çmimin e tregut, llojin e pasurisë dhe qëllimin e përdorimit të saj, sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Procesit të vlerësimit të pronës, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohen:

a) toka;

b) objektet ndërtimore.

Në kategorinë e tokës përfshihen toka bujqësore, toka pyjore, pyjet, livadhet dhe kullotat, tokat e pafrytshme, si dhe trualli, pavarësisht masës dhe qëllimit publik apo privat të përdorimit të tij.

Në kategorinë e objekteve ndërtimore përfshihen ndërtesat dhe strukturat inxhinierike, që e gëzojnë këtë cilësi sipas legjisllacionit në fuqi.

Treguesit bazë të vlerës së pronës caktohen të veçanta për tokën dhe objektet ndërtimore. Kur një pronë është bashkim i tokës me objektin ndërtimor, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet.

3. Metodologjia për vlerësimin e pronës, sipas kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Baza e të dhënave shtetërore të vlerësimit të pasurive të paluajtshme krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilin përcaktohen:

a) institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore;

b) të dhënat parësore dhe dytësore;

c) dhënësin/dhënësit e informacionit;

- ç) ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave;
- d) niveli i aksesimit për subjektet e interesuara.”.

#### Neni 3

Në nenin 24 data “31.12.2011” zëvendësohet me datën “30.4.2014”.

#### Neni 4

Në nenin 28 data “31.12.2011” zëvendësohet me datën “30.4.2014”.

#### Neni 5

Pas nenit 28/3 shtohet neni 28/4 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 28/4

#### **Koordinimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës**

1. Ministria e Drejtësisë, në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtaritë e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, Drejtorisë së Administrimit të Shitjes së Pronës Publike, Komisionit Qeveritar të Tokës, Avokaturës së Shtetit, si dhe të çdo institucioni tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi këtë proces. Çdo institucion shtetëror, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi mbi procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe të sigurojë informacionin apo dokumentacionin e kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe të raportojë arsyet e mospërmbushjes së një mase apo rekomandimi të kërkuar.

2. Ministria e Drejtësisë i ushtron këto përgjegjësi nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, e cila:

a) përgatit rekomandime për masat ligjore dhe organizative mbi çështjet e të drejtave të pronësisë, duke mbikëqyrur procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe procesin e zbatimit të masave strategjike të miratuara;

b) harton programe, analiza tekniko-ligjore, studime për efektivitetin dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme ligjore dhe ekzekutive për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë;

c) mbështet, bashkëpunon dhe bashkërendon punët e saj me institucionet e tjera shtetërore, të përfshira në procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave;

ç) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe transmetimin e ndërsjellë të informacionit dhe dokumentacionit midis institucioneve të tjera shtetërore për përditësimin e të dhënave të tyre në funksion të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës;

d) ndjek dhe realizon çdo detyrë tjetër të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

3. Këshilli i Ministrave, me vendim, cakton rregulla të hollësishme për procedurën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë me institucionet e tjera shtetërore.

4. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Koordinimit është pjesë e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë, që miratohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Rregulla të hollësishme për ushtrimin e veprimtarive nga Drejtoria e Koordinimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë.”.

#### Neni 6

#### **Dispozitë kalimtare**

1. Çdo dispozitë ligjore dhe çdo vendim në zbatim të saj, që rregullon vlerësimin e pronës që i kompensohet subjekteve të shpronësuara, shfuqizohet.

2. Vlerësimi i pronës që i kompensohet subjekteve të shpronësuara, deri në miratimin e akteve



nënligjore për vlerësimin e pronës, sipas këtij ligji, rregullohet sipas dispozitave të mëparshme.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 7  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.5.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7495, datë 24.5.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr. 49/2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9235, DATË 29.7.2004, “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 24, data “30.4.2014” zëvendësohet me datën “30.4.2015”.

Neni 2

Në nenin 28, data “30.4.2014” zëvendësohet me datën “30.4.2015”.

Neni 3

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.5.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8575, datë 27.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 47/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9235, DATË 29.7.2004, “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Afati për procesin e njohjes, të kthimit e të kompensimit të pronave të paluajtshme dhe afati për kryerjen e procesit të pagesës së kompensimit, të përcaktuar në nenin 23, të këtij ligji, është data 30.10.2015.”.

**Neni 2**

Në nenin 28, data “30.4.2015” zëvendësohet me datën “30.10.2015”.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 7.5.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9107, datë 21.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 26, datë 2.11.2005**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtar e “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pilloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 11.4.2005 dhe 21.4.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.33 Akti, që i përket:

**KËRKUESI: SHOQATA E QIRAMARRËSVE NË SHTËPITË SHTETËRORE, ISH-PRONË PRIVATE**, përfaqësuar nga zoti Piro Polo dhe avokate Luljeta Petani, me prokurë.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Viktor Gumi, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
3. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, si antikushtetues.

Kërkuesit kanë paraqitur këto shkaqe:

- Neni 9 i ligjit të lartpërmendur i diskriminon qiramarrësit në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.
- Shteti nëpërmjet rregullimeve të ndryshme ligjore ka krijuar diferencime edhe midis vetë qiramarrësve.
- Neni 9, padrejtësisht, vë afate kohore të shkurtra për lirimin e banesave, duke krijuar artificialisht pamundësi për Buxhetin e Shtetit për ndërtimin e apartamenteve të nevojshme.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

Me kthimin te pronarët e ligjshëm të pronave të tyre të marra arbitrarisht, qysh nga dalja e dispozitave përkatëse të vitit 1993, lindi nevoja e sistemimit dhe trajtimit të qiramarrësve të shtëpive shtetërore që do t’u ktheheshin pronarëve.

Nga viti 1993 e deri më tani, për rregullimin e këtij problemi sa ekonomik e juridik, po aq dhe

social, kanë dalë një sërë dispozitash, e veçanërisht me rëndësi për çështjen është ligji nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.8647, datë 24.7.2000. Ky rregullim ligjor ka vazhduar deri në gusht 2004, kohë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr.9188, datë 1.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, neni 9 i të cilit kontestohet nga kërkuesit.

Në këtë dispozitë parashikohet:

“1. Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, lirohen nga qiramarrësi brenda një afati 3-vjeçar. Qiramarrësit vazhdojnë të paguajnë qira të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave deri në dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave ngarkohet të sigurojë strehimin e qiramarrësve që kanë statusin e të pastrehëve nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interes të ulët ose banesave me qira të kompensuar nga shteti;

2. Në rastet e banesave të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, banorët e tyre kanë të drejtën e blerjes së truallit gjatë procesit të legalizimit, të përcaktuar me ligj të veçantë. Vlerësimi i truallit bëhet sipas vlerës së tregut në momentin e kryerjes së legalizimeve të banesave.”

Nga analiza e dispozitave të mësipërme, të ballafaquara me parimet dhe normat kushtetuese, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9188, datë 1.7.2004 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Deri në miratimin e hyrjen në fuqi të kësaj dispozite, qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private, kishin një sërë të drejtash, nga ku, në rrjedhën e disa viteve, një pjesë prej tyre përfituan. Ndër më kryesoret e këtyre të drejtave ishin: deri në zgjidhjen e strehimit, qiraja do të ishte sipas tarifave të vitit 1993 (neni 4 i ligjit nr.8647, datë 24.7.2000); shteti u siguronte banesë nga Enti Kombëtar i Banesave sipas kriterëve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 (neni 1 i ligjit të lartpërmendur). Siç shihet sipas këtyre dispozitave, shteti mernte përsipër t’u siguronte banesë kundrejt privatizimit sipas kriterëve që shërbyen për privatizimin e banesave në vitin 1992 dhe së dyti deri në zgjidhjen e problemit qiraja nuk do të ndryshonte.

Ligji i ri nr.9235, datë 29.7.2004, në pikën 1 të nenit 9, bën ndryshime esenciale të të drejtat e qiramarrësve. Kështu ndërsa me dispozitat e mëparshme shteti merrte përsipër të zgjidhte strehimin duke i bërë kërkuesit pronarë mbi të njëjtat kritere që përfitoi pjesa tjetër e popullit, dispozita e kontestuar nuk parashikon shprehimisht këto detyrime të shtetit. Dispozita parashikon sigurimin e strehimit të tyre nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interesa të ulëta ose banesave me qira të kompensuara nga shteti.

Veç kësaj, në dallim nga dispozita e mëparshme që “ngrinte” qiranë e banesave deri në zgjidhjen përfundimtare të strehimit të qiramarrësve (neni 10 i ligjit nr.8030, datë 15.11.1995), dispozita që kontestohet parashikon shprehimisht pagimin e kësaj qiraje “të ngrirë” deri në dy vjet nga hyrja e ligjit në fuqi, duke nënkuptuar që pas këtij afati qiraja liberalizohet.

Në ligjin e ri parashikohen edhe masa të tjera të cilat keqësojnë në një shkallë të ndjeshme pozitën e qiramarrësve. Kështu ndërsa në ligjin e mëparshëm (të shfuqizuar) si afat kohor për lirimin e banesave merrej shprehimisht koha kur do të zgjidhej përfundimisht strehimi i qiramarrësve, në dispozitën e kontestuar, në mënyrë arbitrare e pa asnjë garanci të shprehur, parashikohet që qiramarrësit të lirojnë banesat brenda një afati 3-vjeçar.

Nga paraqitja e mësipërme del qartë që pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 cenon ndjeshëm një sërë të drejtash që kërkuesit kishin siguruar nëpërmjet legjislacionit, i cili ka pasur në përmbajtjen e tij edhe rekomandime që dilnin nga vendime të Gjykatës Kushtetuese.<sup>1</sup> Për më tepër, këto të drejta u realizuan për një pjesë të qiramarrësve duke ngelur pa u realizuar për një numër të konsiderueshëm, të cilëve, ashtu siç u parashtrua më lart, iu imponohen zgjidhje të reja, haptazi të pafavorshme e cilësisht të dallueshme nga ato të mëparshmet.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për

<sup>1</sup> Vendimi nr.5, viti 1997 i Gjykatës Kushtetuese.

kthimin dhe kompensimin e pronës”, ka shkelje me karakter konceptual, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e shtetit të së drejtës, garantuar nga nenet 15, 17 e 18 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. “Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht.”<sup>2</sup>

Duke afirmuar parimin e sigurisë juridike dhe të elementeve kryesore përbërëse të saj, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.

Nga shqyrtimi i çështjes del se, në rastin e dhënë, ndryshimi i ligjit të favorshëm ndaj një grupi të caktuar të popullsisë, nuk justifikohet me ndonjë interes publik të qenësishëm. Është e vërtetë që dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e banesave, por nga ana tjetër ajo diskriminon një grup tjetër (dhe pse të vogël në numër), duke ia cenuar të drejtën minimale për të jetuar, atë të pajisjes së një strehe. T’u mohosh të drejtën shtresës së qiramarrësve për t’u bërë pronarë, t’u ndërpresësh kontratën e qirasë pa i garantuar strehë tjetër, janë veprime që nuk mund të përlligjen me interesin publik.

Parimi i sigurisë juridike nuk mund të eliminojë çdo pasojë negative që mund t’i vijë individit nga rregullimi i ri. Kjo për shkak se siguria juridike është e pandashme nga parimi i shtetit social. Por, në rastin në shqyrtim, fjala nuk është për pasoja çfarëdo, por për pasoja thelbësore, sepse dispozita e re realizon një ndryshim konceptual mbi raportet e shtetit me qiramarrësit e banesave pronë private, ndryshim që sjell pasoja shumë të rëndësishme. Me raportet e vendosura me dispozitat e mëparshme, shteti kishte obligimin e zgjidhjes së strehimit të kësaj shtrese duke i bërë pronarë (ashtu si pjesën më të madhe të shtetasve të tjerë), me dispozitën e re të kontestuar, ai (shteti) i tkurr tej mase këto obligime, duke marrë përsipër, kryesisht, vetëm sigurimin e strehimit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se dispozita e re (pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”) nuk është rezultat i një interesi publik apo i kërkesave të shtetit social. Përderisa në rastin konkret, pa as një shkak të përlligjur, është prekur parimi i sigurisë juridike, kjo dispozitë është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet.

Meqenëse me shfuqizimin e kësaj dispozite krijohet boshllëk lidhur me trajtimin e qiramarrësve në shtëpitë e ish-pronarëve, bazuar në nenin 78 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i rekomandohet Këshillit të Ministrave e Kuvendit të Shqipërisë të marrin masa për të bërë plotësimet e nevojshme në ligj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

---

<sup>2</sup> Klaus Itern, Dus Staatsrecht des Bundes Republik Deutschland Band I-834.

## VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

## VENDIM Nr.11, datë 4.4.2007

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Pllloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 6.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41/11 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** SHOQATA E QIRAMARRËSVE TË SHTËPIVE SHTETËRORE ISH-PRONË PRIVATE, përfaqësuar nga avokate Luljeta Petani, me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”, përfaqësuar me avokat Agim Tartari, me autorizim.
2. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, këshilltar juridik, me autorizim.
3. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj, këshilltar juridik, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

Pala kërkuese ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitës së kundërshtuar të ligjit të mësipërm:

- Neni 9 pika 1 e ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 2.11.2005, për shkak se qiramarrësve me këtë dispozitë u cenoheshin të drejtat e fituara.

- Neni 9 i ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” vjen në kundërshtim me rekomandimet e vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese. Ky nen është diskriminues, sepse nuk parashikon detyrimin e shtetit për të marrë përsipër strehimin e qiramarrësve, mbi të njëjtat kritere që përfitoi pjesa tjetër e popullsisë sipas ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Pllloçi, përfaqësuesen e palës kërkuese, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

Me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe konkretisht në nenin 9, është rregulluar trajtimi i qiramarrësve të shtëpive shtetërore ish-pronë private që do t’u ktheheshin ish-pronarëve. Kjo dispozitë në pikën 1 parashikon:

*“Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, lirohen nga qiramarrësit brenda një afati 3-vjeçar. Qiramarrësit vazhdojnë të paguajnë qira të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave deri në dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave ngarkohet të sigurojë strehimin qiramarrësve, që kanë statusin e të pastrehëve, nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interes të ulët ose banesave me qira të kompensuar nga shteti.”*

Mbi kërkesën e Shoqatës së Qiramarrësve të Shtëpive Shtetërore ish-Pronë Private, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.26, datë 2.11.2005 ka vendosur shfuqizimin si antikushtetues të dispozitës së sipërcituar, duke arsyetuar, në esencë, se kjo dispozitë shkel parimin e sigurisë juridike (nëpërmjet cenimit të të drejtave të fituara), si dhe diskriminon një grup të popullsisë, siç janë qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private.

Kërkuesi ka kundërshtuar përsëri si jokushtetues edhe nenin 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të miratuar pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të dispozitës së mëparshme. Neni 9 pika 1 i ligjit në fuqi parashikon: *“Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, të cilat u janë dhënë me qira qiramarrësve nga shteti para hyrjes në fuqi të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe që shfrytëzohen për nevoja strehimi, kalojnë në posedim të subjekteve të shpronësuara, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:*

*a) qiramarrësit kanë plotësuar nevojat e tyre për strehim në çfarëdo mënyrë tjetër të ligjshme;*  
*b) subjektet e shpronësuara u ofrojnë qiramarrësve strehim në sipërfaqe jo më të vogël dhe me kushte të përafërta me strehimin që kanë në përdorim, brenda së njëjtës njësi të qeverisjes vendore, derisa qiramarrësit të plotësojnë nevojat e tyre për strehim në njërin nga mënyrat e tjera të parashikuara në këtë nen;*

*c) qiramarrësit nënshkruajnë kontratën e kredisë me institucionin financiar, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”;*

*ç) qiramarrësit përfitojnë strehim ose truall, sipas pikës 3 të nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.*

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese verifikoi nëse neni 9 i kundërshtuar është në harmoni me vendimin e mësipërm, pra nëse prek përsëri të drejtat e fituara të qiramarrësve të banesave ish-pronë private dhe nëse shkakton diskriminim.

Sipas vendimit nr.26, datë 2.11.2005 të cituar më sipër, deri me hyrjen në fuqi të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private kishin një sërë të drejtash, të tilla si e drejta e qirasë sipas tarifave të vitit 1993 deri në zgjidhjen e strehimit (neni 4 i ligjit nr.8647, datë 24.7.2000), sigurimi i banesës nga shteti, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, sipas kriterëve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (neni 1 i ligjit). Neni 9 i ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” nuk parashikon më detyrimin e shtetit t’u siguronte banesë këtyre

qiramarrësve nëpërmjet privatizimit të banesave sipas kritereve të ligjit sipërcituar të vitit 1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Kjo dispozitë parashikon strehimin e qiramarrësve *nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interesa të ulëta ose banesave me qira të kompensuar nga shteti*. Përveç kësaj, ndërsa rregullimi i 2004 ruan *ngrirjen e qirasë* vetëm për dy vjet, *detyrimin për lirim e banesës* nuk e lidh me strehimin përfundimtar të qiramarrësit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe rregullimi ligjor i bërë nëpërmjet nenit 9 të ligjit objekt shqyrtimi, në esencë, ofron po ato alternativa që ofronte neni 9 i shfuqizuar, të cilat, me vendimin e sipërpërmendur, janë konsideruar jokushtetuese, sepse cenojnë parimin e sigurisë juridike, si dhe shkaktojnë diskriminim të një grupi. Kështu, si alternativa të strehimit të qiramarrësve të kësaj kategorie parashikohen *plotësimi vetë i nevojave të strehimit, sigurimi i strehimit nga ana e subjekteve të shpronësuar, strehimi nëpërmjet kredisë, sipas pikave 1 dhe 2 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, si dhe strehimi ose marrja e truallit, në bazë të pikës 3 të ligjit të sipërcituar*. Ky rregullim ligjor cenon të drejtën e kësaj kategorie qiramarrësish dhe përse i përket *ngrirjes së qirasë*, ndërsa *detyrimin për lirim e banesës* nuk e lidh me strehimin përfundimtar të qiramarrësve.

Gjykata Kushtetuese konstaton, gjithashtu, se një pjesë e qiramarrësve të banesave ish- pronë private kanë përfituar banesë në kushtet e nenit 1 të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Për pasojë, një trajtim më i pafavorshëm i pjesës tjetër të qiramarrësve, të cilët janë në të njëjtat kushte me të parët, përbën një diskriminim jokushtetues.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se neni 9 i ligjit në shqyrtim, është në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe barazisë para ligjit, dhe si i tillë duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Meqenëse me shfuqizimin e dispozitës në shqyrtim krijohet boshllëk ligjor lidhur me trajtimin e qiramarrësve të shtëpive ish-pronë private, në bazë të nenit 78 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i rekomandohet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të marrë masa për të bërë plotësimet e nevojshme në ligj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 51, 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 9 të ligjit nr.9583, datë 17.7.2006 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



**VENDIM**  
**Nr.27, datë 26.5.2010**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datë 24.11.2009 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.27, 32 / 16 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** GJYKATA E LARTË, AVOKATI I POPULLIT, përfaqësuar nga Florina Nuni dhe Frederik Paskali me autorizim.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Pano dhe Jonida Tafai, me autorizim.

**KËSHILLI I MINISTRAVE,** përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

**AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE,** përfaqësuar nga Aulona Bodo, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 16 dhe 18 të ligjit 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4/1, 17, 41/1,2,3,4, 42/1, 60/1, 131 a), 134 d), dh), 145/2 të Kushtetutës dhe nenet 48 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, përfaqësuesin e Avokatit të Popullit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e palëve të interesuara Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që kërkuan rrëzimin e kërkesave dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Me vendimin nr. 75, datë 21.03.1995 të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim KKKP) Vlorë, trashëgimtarëve të A. K. dhe A. A. u është njohur dhe kthyer në natyrë një sipërfaqe trualli në qytetin e Vlorës.

2. Në datën 12.12.1995, me vendimin nr.91 të ish- KKKP Vlorë, u është njohur dhe kthyer

trashëgimtarëve të R. I. një banesë dhe disa sipërfaqe trualli në qytetin e Vlorës.

3. Me vendimin nr.100, datë 19.04.1996 të ish- KKKP Vlorë, u është njohur dhe kthyer trashëgimtarëve të Q. Ç. një sipërfaqe trualli në qytetin e Vlorës.

4. Duke pretenduar për një sipërfaqe më të madhe trualli dhe se prona e kthyer trashëgimtarëve të Q.Ç krijonte mbivendosje me pronën e tij, L. I. ka ngritur një padi në gjykatë me të cilën ka kundërshtuar dy vendimet e KKKP Vlorë, respektivisht vendimin nr. 91, datë 12.12.1995 në favor të trashëgimtarëve të R. I. dhe vendimin nr. 100, datë 19.04.1996 në favor të trashëgimtarëve të Q.Ç.

5. Me vendimin nr.902, datë 17.05.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë duke çmuar se e drejta e pronës, njohur trashëgimtarëve të Q.Ç. me vendimin e sipërpërmendur të KKKP Vlorë, ka qenë e mbështetur në ligj dhe në prova dhe nuk ka krijuar mbivendosje me pronën e trashëgimtarëve të R. I.

6. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 128, datë 01.03.2005. Gjykata e Lartë, me vendimin nr.147, datë 17.02.2006 ka vendosur mospranimin e rekursit.

7. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP) nëpërmjet vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të saj nr.186, datë 06.03.2008 ka vendosur shfuqizimin e vendimeve nr.75, datë 21.03.1993 dhe nr.100, datë 19.04.1996 të ish KKKP Vlorë në favor të trashëgimtarëve të Q.Ç. dhe A. K., duke e kthyer çështjet për rishqyrtim pranë zyrës rajonale të KKKP Vlorë.

8. Kundër këtij vendimi shtetasit A.Ç., F.K., M.R. dhe Xh.K. kanë bërë ankim pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me pretendimin se Drejtori i Përgjithshëm i AKKP ka disponuar në lidhje me një çështje që ishte zgjidhur më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për rrjedhojë, akti i nxjerrë prej tij është absolutisht i pavlefshëm.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.103, datë 21.01.2008, ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor duke argumentuar se, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004, kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP nuk mund të paraqitet ankim në gjykatë.

10. Kundër këtij vendimi paditësit kanë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila më datë 26.03.2009 ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

11. Të njëjtën kërkesë në objekt ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, më datë 14.09.2009 edhe Avokati i Popullit.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje dhe me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi bashkimin e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura nga kërkuesit, për shkak të objektit të njëjtë.

Pretendimet e kërkuesve

*A. Gjykata e Lartë ka pretenduar se:*

12. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP nuk mund të marrë në shqyrtim (mbi ankim administrativ apo edhe kryesisht) edhe vendimet e ish- KKKP, aq më tepër pa asnjë kufi kohor. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP nuk mund të marrë në shqyrtim kryesisht vendimet e zyrave rajonale të AKKP. Nenet 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, me kompetencat që i japin Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së cenojnë parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, subjektet e shpronësuara dhe Avokati i Shtetit nuk mund t'i kundërshtojnë vendimet e ish- KKKP pa asnjë afat kohor.

13. Dispozitat e kundërshtuara kanë sjellë si pasojë mohimin e së drejtës së subjekteve, që janë përfitues nga një vendim i mëparshëm i KKKP, për t'u ankuar në gjykatë, në rast se Drejtori i Përgjithshëm i AKKP shfuqizon vendimin dhe kthen dosjen për shqyrtim pranë zyrës rajonale të AKKP.

14. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP, si organ monokratik administrativ në vartësi të Këshillit të Ministrave, merr atributet e një gjykate duke shfuqizuar vendime *quasi* gjyqësore, të konsideruara të tilla nga jurisprudenca e GJEDNJ.

*B. Avokati i Popullit ka pretenduar se:*

15. Përmbajtja e pikës 1 “ç” të nenit 16 të ligjit objekt shqyrtimi dhe fjala “kryesisht”, në paragrafin e dytë të nenit 18 të të njëjtit ligj, bien ndesh me parimet e mbrojtjes së pronës private, të parashikuara në nenin 41 të Kushtetutës.

16. Kompetenca që i është dhënë Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-ve për të shqyrtuar kryesisht dhe për të anuluar vendimet e ish- KKKP-ve është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor;

17. Dispozitat objekt shqyrtimi cenojnë parimin e sigurisë juridike, sepse krijojnë pasiguri për një masë të madhe shtetasish dhe humbet besimi te shteti.

18. Ligji, në dispozitat e kundërshtuara, bie ndesh me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si edhe parimin e ligjshmërisë, të parashikuara nga nenet 7, 42/2, dhe 15/1 të Kushtetutës.

Prapësimet e subjekteve të interesuara

*A) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*

19. Organet administrative, në përputhje me nenin 16/1 të Kodit të Procedurave Administrative, për të mbrojtur të drejtat e shtetasve kanë kompetencë të kontrollojnë aktet e nxjerra prej tyre edhe kryesisht.

20. Afatet dhe procedurat e ankimit dhe ato të shqyrtimit kryesisht, nuk janë të pakufizuara si pretendon kërkuesi, por u nënshtrohen afateve kohore dhe kufizimeve procedurale.

21. Efektet prapavepruese të vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së janë në përputhje me nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative.

22. Neni 18 i ligjit të kundërshtuar nuk përmban dispozita ndaluese për sa i përket ankimit gjyqësor të aktit administrativ, konkretisht, vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP, për kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së. Gjithsesi, veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, i zbërthyer në parimet e paanësisë dhe pavarësisë në vendimmarrje.

*B) Këshilli i Ministrave*

23. Gjykata e Lartë ka gabuar duke referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për një problem me karakter procedural që lidhet me juridiksionin. Në kundërshtim me objektin e kërkesës së paraqitur para saj, Gjykata e Lartë ka analizuar thelbin e mosmarrëveshjes, i cili nuk kishte rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

24. Drejtori i AKKP, në ushtrimin e kompetencave të tij, nuk ka arsye të përmbushë kushtet e një organi të pavarur dhe të paanshëm pasi vendimet e tij janë gjithmonë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

25. Dhënia e kompetencave për kthimin dhe kompensimin e pronave një organi administrativ, siç është AKKP, është një zgjidhje legjislativ e bazuar, sepse ky organ merr përgjegjësitë për zhvillimin e një politike të drejtë në rang vendi.

26. Çështja e referuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim me vendimin nr.2, datë 6.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të të njëjtës gjykatë, i cili parashikon detyrimin për ankuesit që të shterojnë në fillim ankimin në rrugë administrative, para se të kenë të drejtën e rishikimit në rrugë gjyqësore të vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP.

27. Siguria juridike nuk është një parim absolut, por ajo mund të cenohet për interesa publikë, ose në përmbushje të kërkesave të shtetit social.

28. Problemet në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, mund të ngrihen në Gjykatën Kushtetuese nga gjykatat e të gjitha niveleve, por jo nga Avokati i Popullit.

29. Në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës Avokati i Popullit vihet në lëvizje për të mbrojtur interesa të ligjshëm të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike. Në rastin konkret kemi një veprim të Avokatit të Popullit, në mbrojtje të individëve që kanë fituar të drejta në mënyrë të paligjshme.

30. Cenimi i parimit të ndarjes së pushteteve nuk mund të pretendohet nga Avokati i Popullit në Gjykatën Kushtetuese, pasi ai nuk legjitimohet nga neni 60 i Kushtetutës

### *C. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave*

32. Shoqëria “Dudaj Konstruktion”, e cila ka vënë në lëvizje Avokatin e Popullit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, nuk ka as cilësinë e ish-pronarit dhe as cilësinë e subjektit të shpronësuar. Personat që mbajnë këto cilësi për çështjen e referuar nga “Dudaj Konstruktion”, janë aktualisht në proces gjyqësor për të njëjtën çështje dhe duhet të ezauroheshin gjithë etapat e fazës gjyqësore të ankimit para se të investohet Gjykata Kushtetuese.

33. Pretendimet e shoqërisë “Dudaj Konstruktion” dhe për rrjedhojë edhe të Avokatit të Popullit se i janë cenuar të drejtat e saj kushtetuese kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe jo me kushtetutshmërinë e tij.

Për sa më sipër të tre subjektet e interesuara kërkojnë rrëzimin e kërkesave si të pabazuara.

## II

Në lidhje me legjitimitimin e kërkesve

34. Gjykata i konsideron si të pabaza pretendimet e palës së interesuar, Këshilli i Ministrave për mungesën e legjitimitimit të kërkesve.

35. Në lidhje me legjitimitimin e Gjykatës së Lartë (në vijim gjykata referuese), Gjykata Kushtetuese çmon se ky organ, në përputhje me nenet 134/1 germa “d” dhe 145/2 të Kushtetutës, mund të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së normave me kusht që kushtetutshmëria e tyre të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete.

36. Gjykata referuese, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, ka për detyrë të shohë në tërësi pozitën procedurale dhe materiale të palëve dhe gjendjen e tyre pas zgjidhjes së çështjes konkrete. Pra, gjykata referuese duhet të vlerësojë pozitën juridike të palëve pas zbatimit të ligjit konkret. Me fjalë të tjera, gjykata është e detyruar të bëjë një vlerësim apriori të pasojave të mundshme që do të kishte një vendim i saj duke zbatuar ligjin konkret.

37. Nëse gjykata referuese ka bazë të arsyeshme të vlerësojë se zgjidhja e çështjes nga ana e saj, duke aplikuar ligjin konkret, mund të çojë në cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve, atëherë ajo autorizohet nga urdhërimi i normës kushtetuese që ta referojë çështjen për zgjidhje të problemit të kushtetutshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese.

38. Në rastin konkret, gjykata referuese ka konstatuar se pala ankuese është detyruar të mbrojë të drejta subjektive të saj, të cilat i ka fituar me vendime të formës së prerë.

39. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon se një konstatim i tillë nga ana e gjykatës referuese ngre, *prima facie*, probleme kushtetutshmërie, në lidhje me parimin e sigurisë juridike, duke legjitimuar këtë të fundit të kërkojë kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

40. Gjykata referuese, edhe pse ka marrë nismën për kontrollin incidental, pasi Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, ka vlerësuar si antikushtetues, jo vetëm problemin e mosparashikimit të ankimit, ndaj vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, për të shfuqizuar dhe kthyer për rishqyrtim vendimet e KKKP-së, por ka kërkuar në tërësi kontrollin e normave që janë të lidhura pazgjidhshmërisht me ankimin, duke provuar kështu një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet çështjes objekt gjykimi dhe kushtetutshmërisë së këtyre normave.

41. Gjithashtu, Gjykata vlerëson si jo të drejta pretendimet e subjektit të interesuar Këshilli i Ministrave lidhur me moslegjitimitimin e Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë për të ushtruar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës objekt shqyrtimi. Siç është shprehur edhe më parë,

Gjykata çmon se: “ Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike. Një nga mënyrat me të cilat ky organ realizon funksionin e tij është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën.” (shih vendimin nr. 40 të vitit 2007.)

42. Për sa më sipër Gjykata vlerëson se është në diskrecionin e Avokatit të Popullit të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve nëse një normë është *prima facie* si antikushtetuese. Pretendimi se nisma e Avokatit të Popullit është e pabazuar pasi norma nuk është antikushtetuese dhe se interesat e mbrojtur nuk janë të ligjshëm, nuk mund të shërbejë si bazë për të rrëzuar kërkesën e Avokatit të Popullit, pasi këto elemente vlerësohen nga Gjykata nëpërmjet procesit kushtetues dhe nuk mund të paragjykojnë, as prej saj dhe as nga palët e interesuara.

Për sa më sipër Gjykata çmon se të dy kërkesit legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

### III

Lidhur me pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

43. Parimi i sigurisë juridike del nga preambula e Kushtetutës në të cilën përshkruhen aspiratat e popullit shqiptar për një shtet të së drejtës, si edhe nga neni 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë shtetërore.

44. Siguria juridike është një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës dhe ka si qëllim të garantojë shtetasit se një marrëdhënie juridike e përcaktuar nga një vendim i formës së prerë është e pandryshueshme.

45. Për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e neneve 16 dhe nenit 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, Gjykata e sheh me vend të konsiderojë nëse kompetenca e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP për të shqyrtuar ankimet mbi vendimet e dhëna nga ish- KKKP dhe zyrat rajonale aktuale të agjencisë, si edhe për të shqyrtuar kryesisht këto vendime, është në përputhje me Kushtetutën. Për t’i dhënë përgjigje kësaj çështjeje Gjykata e çmon të arsyeshme të evidentojë dallimin ndërmjet të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve, të cituara në nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo analizë bëhet akoma më e domosdoshme po të mbajmë parasysh se gjithë procesi i rregulluar nga nenet objekt kontrolli, i përket revokimit ose shfuqizimit të akteve administrative sipas nenit 121 të Kodit të Procedurave Administrative.

46. Sipas së drejtës administrative shqiptare, për të pasur një akt administrativ i cili të shprehë vullnetin e organit administrativ nevojitet një interes i ligjshëm publik. Kërkesa e një personi para organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave synon njohjen e së drejtës së pronës mbi një send të caktuar. Kjo e drejtë e pretenduar nga subjekti para një organi shtetëror është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë, nga ana tjetër, se vendimet e KKKP dispononin drejtpërsëdrejti mbi të drejta subjektive, të cilat janë ekskluzive të titullarëve të caktuar dhe jo të shtetasve apo publikut në tërësi siç janë interesat publikë. Ky fakt mund të konstatohet nga Gjykata, pasi e drejta e një personi për t’u njohur si pronar i një sendi rregullohet nga Kodi Civil, si rrjedhim Gjykata çmon se jemi jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike, e cila rregullon veprimet e organeve shtetërore në mbrojtje të interesave publikë.

Për sa më sipër, vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte *sui generis* të nxjerra nga një organ *sui generis*, për të cilin Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, *quasi gjykatë*.

47. Në mbështetje të konstatimit të mësipërm, Gjykata ka vlerësuar faktet e mëposhtme: Gjykata çmon, mbështetur edhe në eksperiencën e vendeve të tjera, se në rastet kur kemi të bëjmë me

të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror ka shprehur vullnetin e vet nëpërmjet akteve, këto të fundit nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte administrative, por përkundrazi, shtetasi në gjykatë, në një gjykim të zakonshëm kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të kësaj të drejte.

48. Situata paraqitet ndryshe kur një subjekt pretendon se një akt shpronësimi i cenon të drejtat e veta pasurore ose reale. Duke qenë se në këtë rast jemi para një interesi publik, subjekti kërkon mbrojtjen e interesit të vet të ligjshëm dhe për këtë qëllim kundërshton aktin publik i cili ka karakteristikat e aktit administrativ.

Për pasojë, Gjykata konstaton se shqyrtimi i së drejtës së pronësisë mbi një send mund të bëhet vetëm nga gjykata e zakonshme, në përputhje me Kodin Civil.

49. Nisur nga arsyetimet e mësipërme, Gjykata çmon të nevojshme të marrë në shqyrtim se përse kërkesa për njohjen e së drejtës së pronës mbi sendet e paluajtshme bëhej pranë KKKP dhe jo në gjykatë. Dy ishin arsye kryesore për këtë mënyrë zgjidhjeje; së pari, organet që duhet të merreshin me kërkesat për kthimin e pronës duhet të ishin të shpërndara në territor dhe të kishin kontrollin kapilar të këtij të fundit dhe së dyti, ato duhej të ishin organe që kishin njohuri specifike për fushën duke garantuar një proces sa më të shpejtë dhe të zhdërvjellë (lexo duke shkarkuar barrën e vlerësimit të kërkesave nga gjykatat).

Për sa më sipër edhe pse kërkesa e personit që pretendonte të rivendosej në të drejtën e pronës ishte një kërkesë tipike në lidhje me një të drejtë subjektive, ajo shqyrtohej nga një organ që nuk ishte një organ gjyqësor. Kjo lloj zgjidhjeje ishte e njëjtë ose e ngjashme në të gjitha vendet e Europës Lindore dhe Qendrore që dolën nga regjime totalitare.

50. Proceset e kthimit dhe kompensimit të pronës në Europë lindën si një nevojë për të vendosur drejtësinë sociale për arsye se individët ishin zhveshur nga prona në përputhje me legjislacionin e kohës, por në kundërshtim me elementet bazë të së drejtës të shteteve demokratike, në të cilat e drejta e pronës private njihet dhe mbrohet nga rendi juridik. Në këto kushte individëve të ndryshëm, të cilët ishin privuar nga e drejta e pronës gjatë regjimeve totalitare, u lindi e drejta që të kërkonin të viheshin në të njëjtat pozita juridike në lidhje me pronën, siç kishin qenë para shtetëzimit. Proceset rrezikonin të shkaktonin konflikte serioze sociale nëse do të kishin qenë thjesht procese ku shtetasit e shpronësuar padrejtësisht do të rivendikonin pronën, duke u mbështetur në aktet e disponuara para shtetëzimeve, pasi një pjesë e pronave u ishin dhënë personave të tjerë, të cilët i gëzonin prej vitesh. Për sa më sipër pronarëve u kthehej kryesisht prona e lirë dhe kompensoheshin nëse prona ishte e zënë. Megjithatë procesi në thelb kishte të bënte me drejtësinë sociale, kërkesa për njohjen e pronësisë lidhej drejtpërsëdrejti me rivendikimin e titullit të pronësisë, në kuptim të nenit 296 të Kodit Civil, i cili në frymën e ligjeve përkatëse për kthimin dhe kompensimin e pronës konstatohet si i përvetësuar padrejtësisht nga shteti.

Në këto kushte kur një person vinte në lëvizje me kërkesë KKKP kjo kërkesë ishte e barasvlefshme si të ishte bërë para gjykatës dhe vendimi KKKP ishte në gjendje që të krijonte te individi të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili i njeh individit pronësinë mbi një send. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen Viasu kundër Rumanisë, Ramadhi, apo Hamzaraj, kundër Shqipërisë, duke barazuar vendimin e KKKP me një vendim gjyqësor i cili krijon pritshmërinë e ligjshme te individi se ose do të vihet në posedim të pronës, ose do të dëmshpërblehet.

51. Si argument shtesë në lidhje me konkluzionin se kemi të bëjmë me të drejta subjektive dhe jo me interesa të ligjshëm, gjithmonë në kuptimin e ndarjes së bërë nga neni 32 i Kodit të Procedurës Civile, gjykata vlerëson edhe faktin se gjykatat e Republikës së Shqipërisë, në momentin që investoheshin për të zgjidhur ankimet në lidhje me vendimet e KKKP, e zgjidhnin çështjen në themel njësoj sikur të ndodheshin para një konflikti të mirëfilltë pronësie. Pikërisht për këto arsye, legjislatori e kishte pajisur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave me garanci në mënyrë që të drejtat e shtetasve të kishin një mbrojtje maksimale. Procesi rregullohej nga një ent i cili nuk ishte i përfshirë në

piramidën e ekzekutivit, por ishte i organizuar në qendër dhe në bazë në mënyrë të pavarur nga ekzekutivi, ndërsa drejtuesit e këtij institucioni emëroheshin direkt nga Kuvendi. Pikërisht kjo është edhe arsyeja se përse Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Driza kundër Shqipërisë, i ka konsideruar KKKP organe të pavarura. Argumentimi që bën Këshilli i Ministrave, nëpërmjet përfaqësuesve të vet, se aktet nënligjore e vinin KKKP në varësi të tij është i pabazë, për arsye se Këshilli i Ministrave rregullonte vetëm mënyrën e funksionimit të këtyre organeve, pa pasur kompetenca emërimi ose shkarkimi që janë tipar karakterizues i raportit të varësisë ndërmjet organeve publike.

52. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se KKKP nuk ishin organe administrative në kuptimin klasik juridik të termit. Ato nuk ishin të përfshira në piramidën e ekzekutivit, dispononin në lidhje me të drejta subjektive të shtetasve dhe vendimet e tyre kontrolloheshin drejtpërsëdrejti nga gjykatat në një gjykim që nuk ishte i njëjtë me atë në lidhje me pavlefshmërinë e aktit administrativ. Për rrjedhojë edhe vendimet e KKKP nuk ishin akte administrative në kuptimin juridik të termit. E drejta administrative nuk mund të rregullojë me akte detyruese (*imperium*) interesa të privatëve kur nuk ekziston një interes publik. Në rastin konkret, fakti që nuk ekziston një interes publik mund të konstatohet edhe nga analiza e nenit 1 të ligjit objekt shqyrtimi, i cili shprehimisht përcakton se objekti i ligjit është kthimi i pronës ish pronarëve në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës.

Për sa më sipër, zbatimi, nga një organ administrativ si AKKP, i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish- KKKP është i pabazuar, pasi mungon një interes i ligjshëm shtetëror dhe aktet që shfuqizohen ose revokohen nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ. Drejtori i AKKP është një organ në vartësi të Këshillit të Ministrave dhe në këtë kuptim vendimi i marrë prej tij për të ndërhyrë mbi interesa civilë të shtetasve, në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është i pajustificuar.

53. Shtetasi subjekt i ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” edhe në mungesë të titullit mund t’i drejtohet AKKP në rrugë administrative dhe pas konsumimit të saj, mund të vërë në lëvizje gjykatën për të kundërshtuar vendimin përfundimtar të organit administrativ. Në të dyja rastet shtetasit gëzojnë mbrojtje të të drejtave subjektive pa qenë nevoja të cenohen nga organi administrativ vendimet e KKKP-ve. Gjykata çmon se në kushtet e mungesës së një interesi të ligjshëm publik, jemi para një cenimi të neneve 41/3, 42/2 dhe 17 të Kushtetutës, pasi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk e pengon një organ administrativ të njohë të drejtën e pronës së shtetasve, por vë si kusht interesin publik për të kufizuar këtë të fundit. Duke qenë se procesi i rishikimit të vendimeve të KKKP-ve kryhet në kushtet e mungesës së interesit publik, duke zbatuar norma të së drejtës publike, të cilat janë të papërshtatshme për të rregulluar të drejta subjektive të shtetasve, kemi për rrjedhojë edhe një cenim të nenit 42/1 të Kushtetutës.

54. Cenimi i parimit të sigurisë juridike do të shkaktonte shumë probleme. Po të kemi parasysh sendet e paluajtshme, cenimi i sigurisë juridike do të shkaktonte një problem të përhapur në të gjithë sistemin ekonomik të një vendi të caktuar, pasi do të cenonte sigurinë e transaksioneve. Paqartësia mbi pronësinë e sendit të paluajtshëm kufizon investitorët dhe pengon zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

55. Përveç problemeve të besimit të investitorëve dhe pasojave negative në zhvillimin ekonomik të vendit, cenimi i parimit të sigurisë juridike ka një ndikim negativ edhe në besimin e qytetarëve se mund të gëzojnë një pronë të pashqetësuar pas një vendimi gjyqësor pozitiv, siç bëhet e qartë nga vendimi nr.9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin thuhet se besimi: “... ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht, ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private, ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme”. Nëse ky besim cenohet atëherë mund të krijohen tensione sociale për të cilat rendi gjyqësor nuk jep përgjigje të shpejtë dhe përfundimtare duke rritur rrezikun e vetëgjyqësisë. Vendimi nr. 9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese përcakton

të drejtën e pronarit të ligjshëm për të gëzuar i qetë pronën pas një vendimi të formës së prerë. E parë në këndvështrimin e palës humbëse në një gjykim i cili është zgjidhur me vendim të formës së prerë, ky argumentim i Gjykatës nuk mund të lexohet ndryshe, përveçse si detyrim i palës humbëse për të mos shqetësuar pronarët e ligjshëm të sendit objekt gjykimi pasi i mungon legjitimimi për të bërë diçka të tillë.

56. Gjykata çmon se vendimet e AKKP për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve, përbëjnë cenim të parimit të sigurisë juridike. Nga analiza e nenit 451 të Kodit të Procedurës Civile del se një vendim gjyqësor i shkallës së parë merr formën e prerë nëse nuk ankimohet, ose kur lihet në fuqi nga një gjykatë apeli, që do të thotë se pamundësia për të vënë në lëvizje gjykatën e apelit, ose vendimi i kësaj të fundit në favor të vendimit të shkallës së parë, i jep atij formë të prerë. Në këtë mënyrë duke arsyetuar *mutatis mutandis*, edhe vendimi i KKKP, i cili nuk është ankimuar brenda afateve ligjore merr formën e prerë. Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* duke cilësuar vendimet e paankimuara të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si “ *të formës së prerë dhe të ekzekutueshme*”.

Duke pasur parasysh këto cilësi të tyre, edhe në lidhje me vendimet e formës së prerë të Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Gjykata mban të njëjtin qëndrim si të GJEDNJ në rastin e çështjes *Brumarescu*, të cituar shprehimisht në çështjen *Driza kundër Shqipërisë*, ku sipas saj një palë e cila ka humbur në bazë të një vendimi të formës së prerë nuk mund të pretendojë rishikimin e vendimit vetëm për arsye se është e pakënaqur me përmbajtjen e tij.

57. Arsyetimi i Këshillit të Ministrave se siguria juridike mund të kufizohet për hir të interesave publikë është i pabazuar, për arsye se vendimet e formës së prerë të gjykatave nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces dhe as nga organet shtetërore, të çfarëdolloj natyre qofshin. Kjo del dhe nga përmbajtja e nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin thuhet se vendimi i formës së prerë është detyrues për gjitha subjektet e sipërpërmendura. Për këto arsye nuk mund të cenohet situata juridike dhe faktike e palëve, e krijuar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, as me vendime të mëvonshme gjyqësore dhe as me akte të ndonjë lloji organi tjetër shtetëror. Nëse vendimeve të gjykatave apo, atyre *quasi* gjyqësore do t’u hiqej efekti i sigurisë juridike nga cilido qoftë, nuk mund të flitej më për pushtet gjyqësor, pasi vendimi do të kishte vetëm fuqi deklarative.

58. Për rrjedhojë nisma ligjore vjen në kundërshtim edhe me nenet 4 dhe 17 pika 2 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6/1, e nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

#### IV

59. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata konstatoi se Kuvendi miratoi ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar”.

Gjykata vëren se neni 2 i këtij ligji, që ndryshon nenin 18 të ligjit objekt shqyrtimi ka parashikuar kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP, për të shqyrtuar vendime të ish-KKKP-ve, kryesisht, ose pas ankimit të shtetasve apo organeve shtetërore, duke disponuar mbi këto vendime të paankimuara të KKKP-ve. Gjithashtu, Gjykata konstaton se neni 3 i ligjit të sipërpërmendur, i cili ndryshon nenin 16 të ligjit objekt shqyrtimi, parashikon të njëjtat kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me vendimmarrjen e strukturave të AKKP-ve në nivel lokal.

Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, duke gjykuar se dispozitat e mësipërme kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim nenet 2 dhe 3 të ligjit të ri.

60. Vlerësimi i normave të sipërpërmendura nga ana e Gjykatës konsiderohet i domosdoshëm për faktin se Gjykata referuese ka pezulluar çështjen gjyqësore para saj dhe se është detyrim kushtetues



për të dy gjykatat që të zgjidhin konfliktet gjyqësore për të cilat investohen. Këtë funksion gjykata referuese e kryen drejtpërdrejt, ndërsa Gjykata Kushtetuese, duke bërë interpretimin përfundimtar të normave që konsiderohen *prima facie* si antikushtetuese nga gjykata referuese.

61. Gjykata konstaton se dispozitat e sipërpërmendura, të cilat posaçërisht ndryshojnë nenet 15/1/ c, ç, d, dh dhe 16 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 mbartin të njëjtat probleme të neneve 16 dhe 18 të të njëjtit ligj para ndryshimeve, të konsideruara më lart si të papajtueshme me Kushtetutën.

62. Lidhur me pretendimin e Avokatit të Popullit për cenim të neneve 5 dhe 7 të Kushtetutës, Gjykata arriti në përfundimin se këto pretendime nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, geramat “d” dhe “dh”, 145/2 të Kushtetutës dhe neneve 48 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 15 pika 1, geramat c, ç, d, dh dhe 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Pllloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza

## MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.103, datë 21.01.2008, ka nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor një çështje lidhur me një vendim të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke argumentuar se në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP nuk lejohet ankimi në gjykatë.

Mbi rekursin e të interesuarve kundër vendimit të sipërcituar, Gjykata e Lartë me vendimin e datës 26.03.2009 ka pezulluar çështjen dhe në rrugën e kontrollit incidental ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në jurisprudencën e saj, ka pranuar se ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmëri ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetueshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes zgjidhjes së çështjes së antikushtetueshmërisë së ligjit nga Gjykata Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata referuese, në kuptimin që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. (*Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.13, datë 4.05. 2009*).

Gjykata e Lartë (gjykata referuese) nuk ka qenë në pamundësi për të zgjidhur çështjen konkrete

duke zbatuar dispozitat përkatëse ligjore. Në rastin në fjalë gjykata referuese nuk mund të investonte Gjykatën Kushtetuese për kontrollin incidental të normës.

Së pari, çështja e paraqitur para saj shtronte për zgjidhje një problem të natyrës procedurale, siç është ajo e juridiksionit, dhe për rrjedhojë duhej të merrte një vendim në përputhje me objektin e kërkesës, për të cilën nuk kishte asnjë pengesë nga pikëpamja ligjore.

Së dyti nga pikëpamja e thelbit të problemit, gjykata referuese e kishte të lehtë të konstatonte dhe të vendoste lidhur me një vendimmarrje haptazi të pabazuar të gjykatës së shkallës së parë. Kjo gjykatë, nisur nga rrethanat e çështjes, në përputhje me nenin 16 të Kodit të Procedurës Penale detyrohej të merrte një vendim, duke shmangur çështjen e juridiksionit. Para saj ishte paraqitur një çështje për të cilën pretendohet se ishte cenuar parimi i gjësë së gjykuar (*res iudicata*). Drejtori i Përgjithshëm i AKKP kishte shfuqizuar një vendim të marrë vite më parë nga ish-komisioni i kthimit dhe kompensimit të pronave, për të cilin ishte shprehur edhe gjykata me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këto kushte, duke qenë se çështja e paraqitur për shqyrtim kishte të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, gjykata e shkallës së parë dhe më pas Gjykata referuese e kishin të lehtë të konstatojnë se ndodheshin para një ndalimi absolut për të marrë në shqyrtim një vendim të formës së prerë i cili, sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile, është i detyrueshëm për të gjitha organet shtetërore. Në këto rrethana si gjykata e rrethit ashtu dhe Gjykata referuese, të cilat nuk mund t'i shmangen respektimit dhe mbrojtjes të një prej parimeve themelore të shtetit të së drejtës, parimit të sigurisë juridike, e kishin për detyrë të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP dhe ta shfuqizonin atë si të tillë. Padia, për kundërshtimin dhe anulimin e një vendimi të organit administrativ për pavlefshmëri absolute, paraqitet në gjykatë dhe zgjidhet nga kjo e fundit e pakushtëzuar nga ankimi administrativ dhe baza juridike e tij.

Janë këto arsye për të cilat mendojmë se në çështjen objekt shqyrtimi nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar dhe zgjidhjes të çështjes konkrete. Për rrjedhojë Gjykata e Lartë nuk legjitimohej për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në rrugën e kontrollit incidental të normës.

## 2. Lidhur me legjitimitimin e Avokatit të Popullit.

Legjitimitimi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese buron nga nenet 60 pika 1 dhe 134 pika 1, germa “dh” të Kushtetutës. Sipas nenit 60, pika 1 të Kushtetutës, Avokati i Popullit “mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”.

Në këtë formulim tërheqin vëmendjen dy çështje: së pari termi i përdorur “individ” dhe së dyti, cenimi i të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës publike.

Lidhur me çështjen e parë, jemi të mendimit se termi “individ” nuk mund t'i referohet edhe entiteteve të tjera, jashtë subjekteve njerëzore dhe kjo për arsye se tashmë ekziston një praktikë e konsoliduar legjislative në Republikën e Shqipërisë sipas së cilës kur legjislatori ka dashur të përfshijë edhe entitete materiale siç janë personat fizikë apo entitete të tjera siç janë personat juridikë përdor termin gjithëpërfshirës “persona” (shih nenin 16/2 të Kushtetutës) dhe asnjëherë termin “individë”, i cili nënkupton ekskluzivisht qytetarët si të tillë. Nëse qëllimi i kushtetutëbërësit do të ishte edhe përfshirja e personave juridikë në sferën e mbrojtjes të të drejtave të tyre kushtetuese nga Avokati i Popullit, do të ishte përdorur termi “persona” dhe jo “individë”. Në të njëjtin përfundim arrijmë edhe nga një analizë gjuhësore e termave të sipërpërmendur, pasi gjuha shqipe nuk e përdor në asnjë rast termin individë për t'iu referuar personave juridikë (Fjalori i Shqipes së Sotme, botim Toena, viti 2002).

Edhe në terma historikë, instituti i Ombudsmanit lindi në Europë për të mbrojtur të drejtat kushtetuese të shtetasve, pavarësisht nëse këta të fundit ishin apo jo në gjendje të paguanin për një mbrojtje adekuate. Në këto kushte ky institut ishte një risi që do të ndihmonte në demokratizimin e

mëtejshëm të shoqërive perëndimore. Edhe në ditët e sotme, kudo në Europë, Ombudsmani mbron interesat kushtetues të shtetasve ose grupimeve të shtetasve, por kurrësi ky institut nuk lindi për të garantuar mbrojtjen e interesave të personave juridikë të cilët supozohet të kenë mundësinë t'i ofrojnë vetes një mbrojtje adekuate nëpërmjet profesionistëve të lirë të së drejtës me anën e shfrytëzimit të rrugës normale gjyqësore.

Lidhur me çështjen e dytë, kushtetutëbërësi e ka çmuar të arsyeshme që veprimtaria e Avokatit të Popullit të jetë e kufizuar vetëm në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet apo mosveprimet e kundërligjshme të administratës publike. Ndryshe nga kushtetutat e disa vendeve të tjera në të cilat Ombudsmanit i është njohur e drejta për të vënë në lëvizje drejtpërsëdrejti Gjykatën Kushtetuese krahas subjekteve të tilla, si Presidentit, Kryeministrit apo një grupi deputetesh, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit bën pjesë në rrethin e subjekteve që kanë të drejtë ta vënë në lëvizje këtë gjykatë në mënyrë të kushtëzuar. Sipas pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mund të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij. Në këtë kuptim, me të drejtë, kjo Gjykatë në jurisprudencën e vet e ka lidhur çështjen e interesave, rrethin e të cilave mbron Avokati i Popullit, me interesat që burojnë nga objekti kushtetues i veprimtarisë të këtij organi dhe jo me interesat e punonjësve të vet. Por nga ana tjetër, mendojmë se kjo Gjykatë do të zgjeronte në mënyrë të gabuar hapësirën kushtetuese të lejuar në qoftë se do të pranonte të vihej në lëvizje nga Avokati i Popullit edhe për çështje që nuk kanë të bëjnë me “mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet e parregullta të organeve të administratës publike”. Duke mos marrë përsipër interpretimin e nenit 60, në kuptimin kushtetues, është e lehtë të konstatohet se qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që Avokati i Popullit të kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të individëve të cenuara nga veprimet e kundërligjshme të nëpunësve të administratës publike, të tilla që kërkojnë një ndërhyrje të menjëhershme me qëllim shmangien e pasojave të kundërligjshme, pa pritur ezaurimin e rrugëve gjyqësore që kërkojnë procedura të shumta dhe një kohë relativisht të gjatë për t'u zgjidhur. Në këtë kuptim Avokati i Popullit legjitimohet gjithashtu ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë edhe për kontrollin e kushtetutshmërisë të normave juridike të një ligji të cilat janë bërë shkas i cenimit të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individëve nga veprimet apo mosveprimet e parregullta të “administratës publike”. Për sa sipër vlerësoj se shumica ka gabuar duke legjitimuar Avokatin e Popullit për mbrojtjen e interesave të një personi juridik, siç është në rastin konkret shoqëria “Dudaj konstruktion”.

### 3. Lidhur me themelin e kërkesës

Gjykata e Lartë dhe Avokati i Popullit kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 16 dhe 18 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata u vu në dijeni se Kuvendi miratoi ligjin nr.10207, datë 23.12.2009, për disa ndryshime në ligjin e sipërpërmendur. Shumica, duke iu referuar në mënyrë të gabuar nenit 48 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese e legjitimoi veten të marrë në shqyrtim edhe përmbajtjen e neneve 2 dhe 3 të ligjit të ri me arsyetimin se kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e gjykimit.

Duke vepruar në këtë mënyrë mendoj se shumica jo vetëm ka gabuar në zbatimin e ligjit, por ka vepruar edhe në kundërshtim me jurisprudencën e kësaj Gjykate.

Neni 48 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të cilit i referohet shumica në vendimin e saj, duke përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, që duhet të jenë si rregull brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, ka parashikuar edhe një përjashtim sipas të cilit i lejohet Gjykatës të vendosë për të marrë në shqyrtim edhe “akte të tjera normative” që kanë lidhje me objektin e kërkesës. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me akte të tjera që kanë lidhje me objektin e kërkesës siç mund të jenë p.sh vendime të Këshillit të Ministrave apo akte të tjera nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të ligjit objekt shqyrtimi por me një ligj të ri, të ndryshuar, i cili ndryshon vetë objektin e gjykimit kushtetues.

Një qëndrim i tillë i shumicës është i gabuar edhe për një arsye tjetër parimore. Shumica i ka dhënë të drejtë vetes që në mënyre indirekte të vihet në lëvizje me nismën e saj, një kompetencë kjo që nuk i është njohur kësaj Gjykate nga Kushtetuta. Në rastin më të mirë, gjithsesi i diskutueshëm, shumica ishte e detyruar të vendoste riçeljen e seancës gjyqësore për të kërkuar shpjegime nga subjektet e interesuara, Kuvendi apo Këshilli i Ministrave lidhur me natyrën, përmbajtjen dhe shkaqet e ndryshimeve në ligjin e ri nr.10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”.

Vendimi i shumicës vjen në kundërshtim edhe me jurisprudencën tashmë të konsoliduar të kësaj Gjykate, që ka të bëjë me qëndrimin e mbajtur më parë për raste të ngjashme. Mjafton të përmendim vendimin nr.4, datë 12.02.2010 me të cilin njëzëri kjo Gjykatë vendoste pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të disa dispozitave të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshtëpërbllimin e ish- të dënuarve politikë të regjimit komunist” me arsyetimin se gjatë shqyrtimit të çështjes ligjvënësi miratoi një ligj të ri që ndryshonte dispozitat objekt shqyrtimi.

Në zbatim të Kushtetutës e ligjit dhe në respekt të jurisprudencës së saj, Gjykata duhet të kishte vendosur edhe për çështjen në fjalë pushimin e gjykimit.<sup>3</sup>

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Admir Thanza

#### MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës në lidhje me legjitimitimin e kërkuarve, si dhe mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes.

##### *A. Në lidhje me legjitimitimin e Gjykatës së Lartë dhe Avokatit të Popullit*

1. Gjykata e Lartë është një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, germa “d” e Kushtetutës që legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur gjatë gjykimit të çështjes çmon se ligjet vijjnë në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme në jurisprudencën e saj se, për inicimin e një gjykimi kushtetues nëpërmjet kontrollit incidental, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjykata referuese duhet të plotësojë dy kushte: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete, pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në gjykim; *së dyti*, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Gjykata (trupit gjykues) duhet të krijojë mendimin se ligji që vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërt, nëse gjykata vlerëson se një ligj është antikushtetues, por zbatimi i tij nuk lidhet me zgjidhjen e çështjes, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 3.02.2010*).

2. Gjykata e Lartë (gjykata referuese) në gjykimin e rekursit të ushtruar kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor gjykimi i çështjes, ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë të neneve 16 e 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” (i ndryshuar).

3. Sipas neneve 59 dhe 472 të Kodit të Procedurës Civile është kompetencë e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që të gjykojë rekursin e veçantë që ushtohet për të kundërshtuar juridiksionin. Rekursi i drejtpërdrejtë është një mjet që shërben për të verifikuar para se çështja të jetë gjykuar në shkallë të parë juridiksionin gjyqësor, me fjalë të tjera sferën e të drejtave/funksioneve që ligji i ka caktuar gjykatës apo organeve të tjera për zgjidhjen e çështjes. Një situatë konflikti midis dy organeve

<sup>3</sup> Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese Admir Thanza është shprehur *pro* përse i përket çështjes së legjitimitimit të subjekteve kërkuarve Gjykata e Lartë dhe Avokati i Popullit.

të pajisura me pushtet publik ekziston atëherë kur të dy organet pretendojnë se duhet të ushtrojnë funksionin e vet, secili me përjashtim të tjetrit, mbi të njëjtin rast konkret, ose në të kundërt që nuk duhet ta ushtrojnë atë, pasi secili organ e konsideron çështjen kompetencë e tjetrit. Rekursi i drejtpërdrejtë mund të ushtrohet si në rastin kur gjyqtari i shkallës së parë ka mohuar gabimisht pasjen e juridiksionit, ashtu edhe rastin kur gjyqtari ka ushtruar gabimisht pushtetin duke gjykuar çështjen, kur ky pushtet i mungonte. Gabimi mbi juridiksionin ka të bëjë me një cilësim të gabuar të lëndës objekt i mosmarrëveshjes, që ndikon mbi veprimtarinë e gjyqtarit (gjykatës), pasi përbën të metë të procedimit.

4. Nga sa më sipër vlerësoj se kërkuesi (gjykata referuese) duhet të argumentonte jo vetëm shkaqet për të cilat normat e kundërshtuara janë antikushtetuese, por edhe faktin se këto norma shërbejnë për zgjidhjen e konfliktit të juridiksionit. Këtë standard që lidhet me legjitimitimin në gjykimin incidental shumica e ka bërë pjesë të arsyetimit të saj, por nga ana tjetër nuk ka analizuar se si normat e kundërshtuara ndikojnë në zgjidhjen e çështjes së juridiksionit gjyqësor.

5. Përmbajtja e nenit 16 të ligjit trajton çështje që kanë të bëjnë me kompetencën e organit administrativ për të ndërhyrë në vendimmarrjet e mëparshme të këtij organi. Kjo normë ka të bëjë me zgjidhjen në themel të çështjes që gjykata e zakonshme ka në shqyrtim dhe jo me juridiksionin, në mënyrë që të legjitimonte Gjykatën e Lartë të pezullonte gjykimin dhe të referonte çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Gjithashtu, përmbajtja e nenit 18 të ligjit (para ndryshimit) nuk e pengonte gjykatën e zakonshme (Kolegjin Civil) që të shprehej mbi juridiksionin në gjykimin e çështjes, në kushtet kur objekti i padisë përbën “gjë të gjykuar” dhe sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile dhe parimit të sigurisë juridike nuk mund të cenohet. Vlerësoj se normat objekt kundërshtimi nuk i shërbejnë zgjidhjes së konfliktit të juridiksionit. Sa më sipër mendoj se nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” për inicimin e një gjykimi incidental.

6. Avokati i Popullit është parashikuar se bën pjesë në rrethin e subjekteve të kushhtëzuara për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (shkronjat “dh”, “e” “ë”, “f” të nenit 134 të Kushtetutës), subjekte këto që duhet të provojnë interesin në një çështje konkrete. Interesi quhet i justifikuar kur kërkuesi provon se pasoja është e drejtpërdrejtë, pra rrjedh direkt nga akti objekt shqyrtimi, është aktuale, dhe sipas rastit, është e lidhur ngushtë me detyrat dhe funksionet e institucionit ose organizatës respektive, në rastin konkret me ato të Avokatit të Popullit. Interesi i këtij subjekti për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të provohej edhe në këtë gjykim, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës (*shih vendimin nr.40, datë 16.11.2007*)

7. Në arsyetimin e saj shumica pranon se “*Pretendimi se nisma e Avokatit të Popullit është e pabazuar, pasi norma nuk është antikushtetuese dhe se interesat e mbrojtura nuk janë të ligjshme, nuk mund të shërbejë si bazë për të rrëzuar kërkesën e Avokatit të Popullit pasi këto elementë vlerësohen nga Gjykata nëpërmjet procesit kushtetues dhe nuk mund të paragjykojnë, as prej saj dhe as nga palët e interesuara*”(paragrafi 42). Nga konkluzioni në cilin ka arritur shumica kuptohet se Gjykata Kushtetuese nuk mund të paragjykojë interesat e mbrojtura, nëse janë të ligjshme apo jo, por çdo nisëm e Avokatit të Popullit duhet t’i nënshtrohet procesit kushtetues. Duke e arsyetuar çështjen e legjitimitimit në këtë mënyrë, shumica i jep Avokatit të Popullit karakteristikat e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të pakushtëzuar (neni 134, pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “ç”). Konkluzioni në të cilin ka arritur shumica nuk është bazuar në vendimmarrjen e mëparshme të kësaj Gjykate. Gjithashtu, paragrafi i shkëputur nga vendimi nr.40, datë 16.11.2007 është cituar në kontekst të ndryshëm nga kuptimi që ka në të vërtetë.

8. Përsa i përket interesit të drejtpërdrejtë të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të individit nga veprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike, vlerësoj se ky interes nuk ekziston. Ky subjekt i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese vetëm mbi bazën e një ankese të paraqitur nga Shoqëria “Dudaj Konstruksion”, pa vlerësuar edhe interesin e subjekteve të tjera. Kompetencat e këtij subjekti për mbrojtjen e interesave të ligjshme të individëve në procesin

legjislativ para miratimit të ligjit apo aktit normativ, përfshijnë si veprimtarinë parandaluese ashtu edhe inicimin e një procesi kushtetues (neni 24 i ligjit nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar). Në këtë vështrim, Avokati i Popullit duhet të provojë cenimin e interesave të individit, duke mos e kuptuar individin në kuptimin e ngushtë, por në tërësisë e subjekteve për të cilat sjell efekte ligji, si një tërësi normash me karakter të përgjithshëm dhe abstrakt. Nga sa më sipër, vlerësoj se Avokati i Popullit nuk arriti të provojë se mbron interesat e individëve të cenuara nga ligji objekt shqyrtimi, por interesat e një subjekti të vetëm.

#### *B. Në lidhje me themelin e çështjes*

1. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje nga Gjykata Kushtetuese, ligjvënësi miratoi ligjin nr.10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, me të cilin u ndryshuan konkretisht edhe nenet 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235.

2. Në vendimin e saj shumica, bazuar në nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, arsyeton se dispozitat e reja (nenet 15-16 të ligjit nr.10207, datë 23.12.2009) mbartin të njëjtat probleme si ato të neneve 16 e 18 të ligjit objekt shqyrtimi (paragrafi 61), pa arsyetuar në mënyrë të hollësishme këtë problematikë, sidomos në vështrim të nenit 18 të ligjit të kundërshtuar, analizë e cila mungon plotësisht në arsyetimin e vendimit. Gjithashtu, dispozitivi i vendimit është i paplotë, pasi nuk shprehet në lidhje me vendimmarrjen e kësaj Gjykate për nenin 18 të ligjit objekt kundërshtimi.

3. Kushtetuta nuk i njeh të drejtën Gjykatës Kushtetuese të vihet në lëvizje kryesisht, por ajo investohet vetëm nga subjektet e parashikuara shprehimisht (neni 134). Neni 48 i ligjit nr. 8577, parashikon se kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashikuara në të. Me zgjidhjen që shumica ka bërë në çështjen konkrete, duke vendosur shfuqizimin e dispozitave të ndryshuara nga ligji nr. 10207 (neni 15 dhe 16), pra të dispozitave të tjera nga ato që ishin objekt i kërkesës dhe për të cilat ajo legjitimoi subjektet kërkuese, vlerësoj se Gjykata është vënë kryesisht në lëvizje, në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës.

4. Nga ana tjetër, shumica, në një vendimmarrje të mëparshme të ngjashme me situatën e krijuar në rastin konkret, që ka të bëjë me ndryshime të ligjit të kundërshtuar pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, njëzëri ka vlerësuar se çështja mbetet pa objekt dhe për rrjedhojë e pushoi atë (*shih vendimin nr.4, datë 12.02.2010*). Në këto kushte, vlerësoj se në rastin konkret shumica, i ka anashkaluar këto standarde të vendosura në jurisprudencën kushtetuese.

Anëtare: Vitore Tusha

### **VENDIM**

**Nr.43, datë 6.10.2011**

### **NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Pilloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 1.3.2011 dhe 23.3.2011, mori në shqyrtim në seancë

gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 2, 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me drejtësi”, përfaqësuar nga avokatët Agim Tartari dhe Spiro Dodbiba, me prokurë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Njazi Jaho dhe Etilda Gjonaj, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, Enkelejd Alibeaj.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Oltion Toro, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar.

2. Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në përfundim të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 7, 15, 17, 41, 42/1, 131/a, 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 45, 49/2, 50, 52/2 të ligjit 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe neni 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Vitore Tusha, përfaqësuesit e kërkuarve që kërkuar pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e palëve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Avokaturës së Shtetit dhe deputetin Enkelejd Alibeaj, që kërkuar rrëzimin e kërkesave dhe, pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

##### I

1. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës, i ndryshuar”. Ky ligj u hartua në plotësim të boshllëkut ligjor të krijuar pas shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese të neneve 15, pikat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009, u miratua nga Kuvendi, pas rrëzimit të dekretit 6664, datë 13.8.2010 të Presidentit të Republikës, dekret me të cilin ligji ishte kthyer për rishqyrtim në organin ligjvënës, pasi ishte vlerësuar se binte ndesh me disa parime kushtetuese.

2. Ligji nr.10308, midis të tjerash, parashikon kompetencën e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP), që mbi bazën e një kërkesë për rishikim të paraqitur nga subjektet e përcaktuara shprehimisht në të, të shqyrtojë vendimet e ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qark, të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe të ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Ligji parashikon, gjithashtu, shkaqet/rrëthanat që justifikojnë paraqitjen e kërkesës për rishikim, subjektet që mund të kërkojnë rishikimin, afatin për paraqitjen e kërkesës për rishikim, procedurat për shqyrtimin në themel të kërkesës dhe vendimmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.

3. Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me drejtësi” (SHKSH) dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) i janë drejtuar, veçmas, Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e ligjit objekt kundërshtimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) dhe Konventën europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ), si dhe pezullimin e zbatimit të këtij ligji deri

në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 28.2.2011, bazuar në nenin 1, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje dhe me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vendosi bashkimin e shqyrtimit të çështjeve të paraqitura nga kërkuessit, për shkak të objektit të njëjtë.

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 28.2.2011, shqyrtoi kërkesën paraprake të deputetit Enkelejd Alibeaj për t’u legjitimuar si subjekt i interesuar në këtë gjykim. Në vështrim të nenit 39/1/b të ligjit “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vlerësoi se ushtrimi i iniciativës ligjvënëse nga ana e deputetit, sipas nenit 81 paragrafi 1 të Kushtetutës për ligjin objekt kundërshtimi, justifikon interesin e drejtpërdrejtë dhe e legjitimoi atë si subjekt të interesuar në interes të gjykimit kushtetues.

## II

A. *Kërkuessi, SHKSH*, në kërkesën e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 6.12.2010, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4. Ligji nr.10 308 cenon parimin e sigurisë juridike, pasi cenon të drejtat e fituara ligjërisht. Vendimet e AKKP-ve janë të barasvlershme me vendimet gjyqësore, të cilat, në rast se nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, marrin formë të prerë, fakt ky që nuk justifikon kërkesën për rishikim.

5. Nenet 16/1 - 16/7, që bëjnë fjalë për rishikimin administrativ të akteve të nxjerra nga ish-zyrat rajonale të AKKP-së, ish-komisionet për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe nga ish-komisionet e rretheve apo bashkive për kthimin dhe kompensimin e pronave vijnë në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, pasi rishikimi i veprimeve dhe i akteve administrative është atribut vetëm i pushtetit gjyqësor dhe nuk mund të kryhet nga organet administrative (nenet 1, 324-333 të KPC-së).

B. *Kërkuessi, KSHH*, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në datën 2.2.2011, ka kërkuar shfuqizimin e ligjit objekt shqyrtimi si të papajtuëshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, mbështetur në këto argumente:

6. Cenohet parimi i sigurisë juridike, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, pasi parashikon të drejtën e rishikimit të vendimeve të AKKP-së, të cilat ashtu si vendimet gjyqësore, nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, marrin formë të prerë.

7. Cenohet parimi i ndarjes së pushteteve, parashikuar në nenin 7 dhe 135 të Kushtetutës, pasi ligji autorizon AKKP-në të shqyrtojë apo rishqyrtojë çështje që mund të ishin objekt shqyrtimi vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Në kuptim të nenit 141/1 të Kushtetutës dhe dispozitave të KPC-së, të drejtën e rishikimit të çështjeve në rrugë gjyqësore e ka vetëm Gjykata e Lartë.

8. Kompetenca e drejtorit të AKKP-së për rishikimin e vendimeve përfundimtare të ish-KKKP-ve, bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës, sepse nuk kemi të bëjmë me interes publik, por me një të drejtë subjektive dhe, për rrjedhojë, shqyrtimi i të drejtës së pronësisë nuk mund të bëhet nga një organ administrativ në varësi të pushtetit ekzekutiv (Këshillit të Ministrave), por vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Ligji, objekt kundërshtimi, përbën në vetvete një kufizim të së drejtës së pronës, që cenon thelbin e vetë të drejtës, pa pasur interes publik dhe as në mbrojtje të të drejtave të të tjerëve ose në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar (neni 17/2).

## III

A. *Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë*, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur:

i) *Në lidhje me legjitimitimin e kërkuessve:*

9. KSHH nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi: nuk paraqitet ndonjë fakt ose rrethanë për të justifikuar pretendimin e KSHH-së se gjatë zbatimit të këtij ligji ndaj individëve (në rastin më të justifikueshëm anëtarë të KSHH-së), por edhe individëve të tjerë, të jenë shkelur të



drejtat dhe liritë themelore; objekti i veprimtarisë së KSHH-së për përsosjen e legjislacionit vendas, sidomos dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, nuk e legjitimon atë t'i drejtohet kësaj Gjykate, por thjesht t'u drejtohet subjekteve kushtetuese propozuese të projektligjeve, komisioneve parlamentare ose institucioneve të tjera, duke ju shprehur atyre opinione për projektligje apo ligje të caktuar; KSHH-ja nuk mund të barazohet me subjektet kushtetuese, të cilët kanë një prerogativë kushtetuese të pakushtëzuar për t'iu drejtuar kësaj Gjykate dhe nuk mund të ketë diskrecion më të gjerë se Avokati i Popullit, të cilit ligji organik dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë mundësinë e paraqitjes së një kërkesë për shfuqizimin e një ligji, pas shqyrtimit nga ky institucion të kërkesave të individëve për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese nga zbatimi i tij.

10. SHKSH nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk parashtron asnjë argument mbi të drejtën e kësaj shoqate për të ngritur pretendime për shfuqizimin e ligjit.

*ii) Në lidhje me themelin e çështjes:*

11. Pretendimi i kërkuarve se ligji cenon parimin e sigurisë juridike, në vështrim të neneve 4, 41, 42 dhe 132 të Kushtetutës, është i pabazuar, pasi asnjë nga këto norma kushtetuese nuk ka qasje të drejtpërdrejtë me ligjin e miratuar nga Kuvendi. Ligji i referohet një numri të përcaktuar vendimesh të KKKP-ve, të cilat kanë shkelje ligjore dhe, si të tilla, duhen korrigjuar.

12. Përfshirja e institutit të rishikimit, si një mjet i përshtatshëm, i njohur dhe i perceptueshëm sipas rregullimeve të KPC-së, jo vetëm nuk bie ndesh me asnjë nen të Kushtetutës ose vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por është në koherencë të plotë me to.

*iii) Në lidhje me kërkesën për pezullimin e ligjit:*

13. Kërkuarët nuk japin asnjë argument mbështetës për pezullimin e ligjit objekt kundërshtimi, i cili në të vërtetë nuk shkakton asnjë pasojë për interesat shtetërorë, shoqërorë apo interesave të ligjshëm të individëve dhe, për rrjedhojë, nuk ka vend marrja e masës së pezullimit.

*B. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar këto prapësime:*

*i) Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarve:*

14. SHKSH-ja nuk parashtron në kërkesë asnjë argument për të provuar ekzistencën e interesit të drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi, interes i cili është cenuar si rezultat i zbatimit të normave të ligjit objekt kundërshtimi. Edhe baza kushtetuese e kërkesës, neni 134, pika "g" është referencë e gabuar.

15. Interesi i KSHH-së në çështjen objekt gjykimi nuk duhet parë i lidhur me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqate, por me të drejtën e shkelur si pasojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike të kundërshtuar. Interesi i KSHH-së duhet të provohet rast pas rasti, duke evidentuar edhe masën e cenimit, pra dëmin real apo potencial.

*ii) Në lidhje me themelin e çështjes:*

16. Pretendimi i kërkuarve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe, për rrjedhojë, edhe të pritshmërive të ligjshme, është i pabazuar, pasi ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast dhe se interesi publik merr përparësi.

17. Është gjithashtu i pabazuar edhe pretendimi i kërkuarve se ligji cenon parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ligji e ndan juridiksionin gjyqësor nga ai rishikues i AKKP-së dhe nuk lë shteg për mbivendosje ose cenim të ndarjes së pushteteve, për faktin se vendimi i AKKP-së nuk përbën titull ekzekutiv pa ezaurimin e së drejtës së ankimit gjyqësor nga subjektet e interesuara.

18. Ligji respekton saktësisht dhe korrektësisht të gjitha konstatimet juridike të vendimit nr.27, datë 26.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim nuk ka përjashtuar në mënyrë kategorike mundësinë e rishikimit të vendimeve të ish-KKKP-ve.

19. Ligji nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Çështjet e njohjes, të kthimit dhe të kompensimit të pronës janë trajtuar nga ligjvënësi si jashtë juridiksionit gjyqësor, por brenda fushës së veprimit të organeve administrative ose atyre *quasi* gjyqësore, pasi këto të fundit kanë të gjitha mundësitë ligjore dhe institucionale për hetimin dhe verifikimin e plotë administrativ gjatë procedurës për nxjerrjen e akteve administrative për pronësinë.

C. *Subjekti i interesuar, deputeti Enkelejd Alibeaj ka prapësuar pretendimet e SHKSH-së, KSHH-së në mënyrë të përmbledhur, si vijon:*

20. Ligji i ri respekton parimin e sigurisë juridike si në aspektin formal, ashtu dhe në atë material. Procesi i rishikimit nuk cenon pritshmëritë e ligjshme të qytetarëve, të cilat në një shtet ligjor mbrojnë të drejtat e ligjshme dhe jo ato të paligjshme.

21. Gjithashtu, ligji kërkon ekzistencën e shkaqeve dhe arsyeve objektive, të parashikuara në mënyrë shteruese në të, për fillimin e procesit të rishikimit, duke shmangur mundësinë e kërimit të rishikimit bazuar thjesht në pakënaqësitë mbi përmbajtjen e vendimit. Parashikimi nga ligji i mundësisë së rishikimit me anë të një kërkesë nga subjektet e parashikuara nga ligji dhe jo kryesisht nga drejtori i AKKP-së, detajimi i rregullave, procedurave dhe afateve të qarta për rishikimin, eviton çdo premisë për arbitraritet.

22. *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar:*

23. Ligji parashikon kriteret objektive rishikimi dhe një procedurë që mishëron analogjinë me “gjënë e gjykuar”, si në rastin e vendimeve gjyqësore. Shkaqet e rishikimit janë të përligjura për situata shumë specifike dhe vetëm në raste thelbësore kundrejt arritjes së barrës së provës në mbështetje të kërkesës për rishikim nga kërkuesi.

24. Ligjvënësi, për rregullimin e disa situatave specifike të diktuar nga realiteti, ka ndjekur interesin publik duke synuar vënien e drejtësisë sociale, të cilën e ka balancuar me parashikimin e një procedure transparente.

#### IV

25. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) në datë 1.3.2011 shqyrtoi kërkesën për pezullimin e ligjit objekt kundërshtimi. Me qëllim parandalimin e pasojave të pariparueshme që mund t’u vijnë të drejtave dhe lirive themelore të individit, në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vendosi pezullimin e zbatimit të neneve 2, 3, 5 të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”, deri në dhënien e vendimit përfundimtar të saj.

#### ***Lidhur me legjitimitimin e kërkuësve***

26. Gjykata, përpara se të marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuësve dhe prapësimet përkatëse të subjekteve të interesuara, vlerëson të shprehet në lidhje me pretendimin e përfaqësuesve të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave se kërkuësit nuk legjitimohen të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

27. Çështjen e legjitimitimit, Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në funksion të legjitimitimit *ratione personae*, Gjykata ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me rrethin e subjekteve që përfshihen në “*organizata të tjera*” të parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, duke përfshirë organizatat politike (neni 131, shkronja “d”), etnike, kulturore, fetare, gjuhësore (neni 20/2), sindikale (neni 50), shoqërore, ekonomike, tregtare (neni 61/4) dhe të tjera (neni 9/2). Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit “organizatë” edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve, me kushtin që organizimi, programet dhe veprimtaria e tyre të përputhen me parimet demokratike të shtetit të së drejtës.

28. Gjithashtu, në vështrim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, shoqatat (organizata të tjera) janë subjekte që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për të iniciuar gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në këtë kuptim, ato duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me *Kushtetutën (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë*

19.3.2008; nr.17, datë 25.7.2008; nr.4, datë 12.2.2010; nr.9, datë 23.3.2010, nr.4, datë 23.2.2011).

29. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr.16, datë 25.7.2008; nr.4, datë 23.2.2011*). Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë patur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31, datë 18.6.2010*).

30. Gjykata konstaton se SHKSH-ja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 26.10.2010, si person juridik – shoqatë. Sipas aktit të themelimit dhe statutit të datës 10.3.2010, SHKSH-ja është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, e cila synon mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të shpronësuar padrejtësisht, mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe zgjerimin e saj, si dhe përfaqëson interesat e pronarëve përpara shtetit dhe organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare, nxit zhvillimin e të drejtës së pronësisë dhe merr pjesë aktive në përpunimin dhe përmirësimin e legjislacionit civil, ekonomik dhe financiar.

31. Gjykata konstaton se KSHH-ja është regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 19.7.2002 dhe sipas aktit të themelimit dhe statutit (neni 2, pika 4) është një organizatë jofitimprurëse, e cila, midis të tjerash, synon përsosjen e mëtejshme të legjislacionit vendas, sidomos të dispozitave që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve.

32. Kërkuesit pretendojnë shfuqizimin e ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin pronës”, i ndryshuar”, i cili ka për objekt rregullimin e çështjeve të pronësisë që kanë lindur si rezultat i shpronësimeve, shtetëzimeve ose konfiskimeve, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e procedurave për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave, kompetencat e tyre, si dhe afatet ligjore për plotësimin e këtij detyrimi.

33. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se bazuar në statutin dhe aktin e themelimit të kërkuesve, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin ata janë krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej tyre dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat e ligjit, objekt shqyrtimi, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, pasi provojnë dhe interesin e tyre për të vepruar i cili është i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe për rrjedhojë pretendimi i përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, është i papabuar.

## VI

### ***Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës***

34. Kërkuesit kanë pretenduar, midis të tjerash, se ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, duke arsyetuar se, në thelb, ky ligj cenon të drejtat e fituara ligjërisht.

35. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se

nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasojat pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 20.12.2005; nr.9, datë 26.2.2007; nr.4, datë 12.2.2010, nr.24, datë 12.11.2008; nr. 31, datë 18.6.2010*).

36. Gjykata, në referim edhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se siguria juridike presupozon respektimin e parimit të gjësë së gjykuar, që garanton se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rigjykimin e një çështjeje që është zgjidhur me vendim të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010*). Përbashkë nga ky rregull janë procedurat e parashikuara në Kodet e Procedurës Civile dhe të Procedurës Penale mbi rishikimin e vendimeve të formës së prerë.

37. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, ligjet apo dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me normat e Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.29, datë 31.5.2010*).

38. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, Gjykata niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrihen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese. Në këtë kuptim roli dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, është që në përputhje me parimin e proporcionalitetit të verifikojë nëse mjeti i zgjedhur nga legjislatori është më i përshtatshmi për të garantuar sigurinë juridike për të drejtën themelore siç është e drejta e pronës.

39. Në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, Gjykata vlerëson paraprakisht nëse ligji i kundërshtuar ka shtuar kritere ose procedura të reja për zbatim nga AKKP-ja, të cilat vijnë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

40. Ligji objekt shqyrtimi, në nenin 3, parashikon kompetencën e organit administrativ të AKKP-së, për të vendosur në lidhje me rishikimin e vendimeve të mëparshme të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, kur pretendohet nga persona të tretë se janë cenuar në të drejtën e tyre, në rastet e mëposhtme:

“a) zbulohen rrethana të reja apo akte të reja shkresore që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen gjatë shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

b) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilave është dhënë vendimi, të kenë qenë apo të jenë deklaruar më pas të pavërteta me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) vërtetohet se aktet shkresore, në bazë të të cilit është dhënë vendimi, të jenë lëshuar nga zyrtarë të dënuar penalisht për lëshimin e tyre;

d) vendimi përmban një gabim material në fakt ose në ligj, bazuar në faktet e administruara në dosje gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës për njohje, kthim apo kompensim të pronës;

e) zyrtarët që kanë marrë pjesë në dhënien e vendimit kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit;

f) vendimi është i bazuar në një vendim gjyqësor ose akt të një organi tjetër, që ka ndikuar në marrjen e vendimit, dhe që më pas është prishur/ndryshuar.”

41. Legjislacioni që rregullon procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, në të gjithë

historikun e tij në Republikën e Shqipërisë, i ka njohur palëve private të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të organit shtetëror, i cili refuzonte njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës si në rrugë administrative, ashtu edhe në rrugë gjyqësore. Nga ana tjetër, vendimet që njohin, kthejnë apo kompensojnë pronën në vite, të cilat kanë marrë formë të prerë si në rastet kur nuk janë ankimuar në formën dhe afatin që përcaktonte ligji i kohës, apo si pasojë e një vendimi gjyqësor përfundimtar, nuk mund të kenë pasoja për të tretët, pasi këta të fundit nuk kanë qenë palë në proces.

42. Gjykata ka theksuar se: Në kushtet kur një person vinte në lëvizje me kërkesë KKKP-në, kjo kërkesë ishte e barazvlefshme si të ishte bërë para gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje që të krijonte te individi të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili njeh individit pronësinë mbi një send. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Viasu kundër Rumanisë; Ramadhi, apo Hamzaraj; kundër Shqipërisë*, duke barazuar vendimin e KKKP-së me një vendim gjyqësor i cili krijon pritshmërinë e ligjshme të individit se ose do të vihet në posedim të pronës ose do të dëmshpërblehet. (*shih vendim e Gjykatës Kushtetuese nr.27, datë 26.5.2010*).

43. Gjykata konstaton se neni 2 (që shton nenin 15, paragrafi i parë i shkronjës “b” të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar), neni 3 (që shton nenet 16/1; 16/2;16/3; 16/4; 16/5; 16/6 dhe 16/7 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”) dhe neni 5 përcaktojnë se çdo subjekt i shpronësuar, personat juridikë publikë që sipas ligjit të kohës nuk i nënshtroheshin njohjes, kthimit, kompensimit ose Avokatura e Shtetit, kur pretendojnë se ekzistojnë shkaqet e rishikimit sipas nenit 16/1, kanë të drejtë që brenda 45 ditëve nga marrja dijani për shkakun e rishikimit (afat ky që për Avokaturën e Shtetit është jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka lindur shkakun e rishikimit, neni 16/4) të paraqesin kërkesë për rishikim në AKKP kundër vendimeve të ish-zyrave rajonale të AKKP-së në qarqe, të ish KKKP-ve, si dhe ish komisioneve të rretheve dhe bashkive për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Ligji kërkon që vendimet për të cilat kërkohet rishikimi nuk duhet të jenë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë, ose për to gjykata nuk ka dhënë një vendim të formës së prerë (neni (16/2). Me përfundimin e procedurave të rishikimit, Drejtori i AKKP-së, brenda afatit 60-ditor, vendos, sipas rastit, lënien në fuqi të vendimit të rishikuar, ose shfuqizimin e këtij vendimi, ose shfuqizimin dhe zgjidhjen në themel të çështjes (neni 16/7).

44. Drejtori i AKKP-së, midis të tjerash, shfuqizon vendimin e ish KKKP-ve, kompetencë kjo që në vendimin e mëparshëm të kësaj Gjykate, nr.27 datë 26.5.2010 për shfuqizimin e neneve 15 pika 1, geramat “c”, “ç”, “d”, “dh”, dhe nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar me ligjin nr.10 207, datë 23.12.2009, “Për disa ndryshime në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, është konsideruar se përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi zbatimi nga një organ administrativ si AKKP-ja, i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-ve, që nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ, është vlerësuar ndërhyrje e pajustificuar mbi të drejtat civile të shtetasve.

45. Në vlerësimin e Gjykatës, aplikimi në ligj i procedurës për rishikim të vendimeve të ish-KKKP-ve, të cilat nuk janë duke u shqyrtuar në themel në gjykatë apo për të cilat gjykata nuk ka dhënë një vendim themeli të formës së prerë, çon në lindjen e një marrëdhënieje të re midis individëve, të cilëve e drejta e pronësisë u ishte njohur apo kthyer me vendim të formës së prerë të ish KKKP-ve, por që potencialisht mund të zhvishen nga titulli i pronësisë si rezultat i shfuqizimit të këtyre vendimeve nga drejtori i AKKP-së, nga njëra anë dhe të gjitha subjekteve të tjera, duke përfshirë edhe Shtetin, nga ana tjetër.

46. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se titujt e pronësisë të fituar me anë të këtyre vendimeve të ish KKKP-ve nuk mund të anulohen apo shfuqizohen *iure imperi*, pra në mënyrë të njëanshme, me anën e vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet publike përkatëse, në rastin konkret të drejtorit të AKKP-së. Ushtimi i një kompetence të tillë shfuqizuese krijon një

gjendje pasigurie juridike, e cila nuk mund të korrigjohet me zgjidhje që imponojnë veprime po aq të pasigurta, të cilat nuk garantojnë kthimin në ligjshmëri. Vendimet e ish KKKP-ve, nëse nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore, janë vlerësuar si vendime të formës së prerë dhe, për rrjedhojë, të ekzekutueshëm dhe nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces, dhe as nga organet shtetërore, të çfarëdo natyre qofshin.

47. Si përfundim, Gjykata arrin në përfundimin se ligji, objekt kundërshtimi, cenon parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pronës.

***Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës***

48. Kërkesit kanë pretenduar se ligji nr.10 308 cenon parimin e ndarjes së pushteteve, pasi ligji autorizon AKKP-në të shqyrtojë apo rishqyrtojë çështje që mund të ishin objekt shqyrtimi vetëm nga gjykatat e sistemit të zakonshëm. Në kuptim të nenit 141/1 të Kushtetutës dhe dispozitave të KPC-së, të drejtën e rishikimit të çështjeve në rrugë gjyqësore e ka vetëm Gjykata e Lartë.

49. Gjykata e vlerëson këtë pretendim në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 4.4.2007*). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 11.5.2006*).

50. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vlerësuar se në kuptim të nenit 135/1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Ndërsa sipas nenit 36 të KPC-së, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Në vlerësimin e Gjykatës kjo do të thotë se, në aspektin kushtetues e ligjor, pushteti për dhënien e drejtësisë, domethënë pushteti për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, civile apo të tjera, u është dhënë gjykatave.

51. Gjykata konstaton se instituti i rishikimit, i sanksionuar nga ligji objekt kundërshtimi, parashikohet edhe nga normat procedurale civile dhe penale, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi (nenet 494 të KPC-së dhe 450 të KPP-së). Duke krahasuar përmbajtjen e nenit 16/1 të ligjit objekt kundërshtimi me atë të normave procedurale të mësipërme, Gjykata konstaton se ligjvënësi ka përfshirë në ligjin objekt kundërshtimi shkaqe/arsye të ngjashme për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të ish KKKP-ve me ato të parashikuara nga dispozitat procedurale për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

52. Gjykata konstaton, gjithashtu, se ligji nr.10 308, datë 22.7.2010 i ka njohur drejtorit të AKKP-së kompetencën që, në përfundim të procedurave të rishikimit të vendimeve të formës së prerë të ish KKKP-ve mbi bazën e subjekteve të përcaktuara shprehimisht nga ligji, jo vetëm t'i shfuqizojë ato vendime, por, sipas rastit, të zgjidhë edhe çështjen në themel.

53. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata rithekson se drejtori i AKKP-së është një organ monokratik në vartësi të Këshillit të Ministrave, dhe jo organ gjyqësor ose *quasi* gjyqësor, i cili mund të zbatojë parimet e shfuqizimit ose rishikimit të akteve të ish-KKKP-ve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se, ndryshe nga sa pretenduan subjektet e interesuara, statusi dhe parimet që zbaton ky organ, si aksesit, transparenca, vlerësimi objektiv i fakteve dhe provave, nuk i japin atij tiparet e organit *quasi* gjyqësor ose gjyqësor dhe as e legjitimojnë atë në ushtrimin e kompetencës gjyqësore të rishikimit të vendimeve të formës së prerë.

54. Gjykata vlerëson se Kushtetuta nuk e pengon një organ administrativ të njohë të drejtën e pronës së shtetasve, por për të kufizuar këtë të fundit përcakton si kushte interesin publik njëkohësisht dhe shpërblimin e drejtë (*neni 41 i Kushtetutës*). Ligji objekt kundërshtimi synon të ndreqë paligjshmëritë në procesin e njohjes e kthimit dhe jo shpronësimin apo kufizime të të drejtës së pronësisë që barazohet me shpronësimin.

55. Gjykata vlerëson se prona si një e drejtë themelore e njohur me Kushtetutë, me ligj dhe me vendim të ish-KKKP-ve, nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor sipas përcaktimeve të nenit 42 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se vendimet e formës së prerë të ish-KKKP-ve nuk mund të anulohen apo shfuqizohen nga organe administrative.

56. Në përfundim, Gjykata arrin në konkluzionin se nenet 2, 3 dhe 5 të ligjit objekt kundërshtimi bien ndesh me nenet 4, 41 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6/1 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të saj dhe, si të tilla, duhen shfuqizuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a” e Kushtetutës, si dhe në nenet 45, 71 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të neneve 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.10 308, datë 22.7.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi.

Anëtarë kundër: Xheziar Zaganjori, Vitore Tusha, Admir Thanza.